

RAPORT
I VLERËSIMIT PERIODIK TË JASHTËM
Për programin e studimit Studime Specializuese Afatgjata
(SPA) në “ORTOGNATODONCI”
Ofruar nga “ALBANIAN UNIVERSITY”

Ekspertët e Vlerësimit :

Prof. Asc. Çeljana Toti

Prof. Asc. Etleva Qeli (Droboniku)

Two handwritten signatures in blue ink are positioned to the right of the names of the experts. The top signature appears to be 'Toti' and the bottom one appears to be 'Etleva'.

Qershor, 2019

Të dhëna të përgjithshme
Për programin e studimit "Studime Specializuese Afatgjata (SPA)
në "ORTOGNATODONCI"

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:	
1	IAL Aplikues: Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti /Departamenti që e ofron Departamenti i Stomatologjisë Fakulteti i Shkencave Mjekësore
3	Urdhëri/VKM i licencimit UMASH Nr. 428, datë 05.09.2011(*)
4	Urdhëri i riorganizimit Shkresë Nr. 90/2 prot, datë 20.10.2018 (**)
5	Urdhëri/VBA e akreditimit Akreditimi i parë: VBA Nr. 29, datë 19.05.2017
6	Titulli i programit të studimit: "Studime Specializuese Afatgjata " në "Ortognatodonci" (***)
7	Cikli i studimit: Cikli i tretë
8	Kohëzgjatja e programit të studimit: 3 vite
9	Kreditet në total (ECTS): 180 Kredite (ECTS)
10	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/): Me kohë të plotë
11	Gjuha (shqip/tjetër): Shqip
12	Programi ofrohet vetëm nga institucioni PO
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera -
14	Diplomë e përbashkët /Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): N/A
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve 8
16	Numri i studentëve Brezi 2014-2017 30 studentë (****) Viti akademik 2018-2019 28 studentë

Tabela e mësipërme plotësohet nga specialist i ASCAL

(*) Emërtimin "**Orthodonci**" programi e ka patur deri në datën 31.10.2018, kur është bërë përditësimi në sistem në bazë të njoftimit të universitetit me Shkresë Nr. 90/2 prot, datë 20.10.2018

(**) Riorganizimi i programit është dhënë si rekomandim nga akreditimi i parë. MASR me Shkresë Nr. 90/2 prot, datë 20.10.2018 bën pranimin e ndryshimeve të bëra nga AU deri në masën 20% për programin e studimit. Këto ndryshime prekin edhe emërtimin e programit të studimit i cili në bazë të Shkresës së MASR Nr. 2635/1, datë 19.07.2018 bëhet "**Ortognatodonci**".

(***) Forma e diplomës për këtë program studimit është regjistruar me UMASR Nr. 552, datë 01.11.2017 "**Diplomë Specializimi**" në "**Orthodonci**"- sipas emërtimit të hapjes dhe akreditimit të parë të programit.

(****) Brezi i studentëve 2014-2017 (30 studentë) megjithëse u përfshinë gjatë vlerësimit për akreditimin e parë nuk përfituan nga vendimi i akreditimit (shih Akreditimi i parë: VBA Nr. 29, datë 19.05.2017). Gjatë vizitës në Institucion u deklarua se ato nuk kanë mbrojtur akoma Tezën e Diplomës

HYRJE

Programi i studimit “Studime Specializuese Afatgjata në “Ortognatodonci” është liçensuar bazuar në Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 428, datë 05.09.2011 (për të gjithë SPA). Programi e ka patur emërtimin SPA në “Orthodonci” deri në datën 31.10.2018, kur është bërë përditësimi në bazë të ndryshimeve të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, bazuar në Standardet për Vlerësimin dhe Akreditimin e Programeve të Studimeve të Specializimeve Afatgjata në Fushën e Mjekësisë, si dhe në Udhëzimin Nr.31, datë 29.12.2017, ku kurrikula mësimore e këtij programi riorganizohet me Vendim Senati Akademik Nr.18, datë 19.06.2018, nën masën 20% dhe pranohet nga MASR me shkresë Nr. 2635/1 Prot datë 19.07.2018.

Me Shkresë Nr. 90/2 prot, datë 20.10.2018 është bërë njoftimi i universitetit në ASCAL.

Fillimisht programi i SPA në “Orthodonci” u çel në Mars 2012: brezi i pare i specializantëve 2012-2015; brezi i dytë 2014-2017. Regjistrime të reja pas vitit 2014, nuk janë kryer në pritje të udhëzimeve të MAS dhe përmbyshjes së rekomandimeve të dhëna nga Bordi i Akreditimit me Vendim Nr.29, datë 19.05.2017.

Me ndryshimet e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, bazuar në Standardet për Vlerësimin dhe Akreditimin e Programeve të Studimeve të Specializimeve Afatgjata në Fushën e Mjekësisë si dhe Udhëzimin Nr.31, datë 29.12.2017 kurrikula mësimore e këtij program, riorganizohet me Vendim Senati Akademik Nr.18, datë 19.06.2018 nën masën 20% dhe pranohet nga MASR me shkresë Nr. 2635/1 Prot datë 19.07.2018. Këto ndryshime prekin edhe emërtimin e programit të studimit i cili bëhet “Ortognatodonci”.

Pas propozimit nga Njësia Kryesore, Nr 928/1 Prot, datë 26.09.2018 për hapjen e programit të Ciklit të Tretë të Studimeve “Specializime Aftgjata në Ortognatodonci” për vitin akademik 2018-2019, Albanian University me Vendim Senati Akademik Nr.47 datë 28.09.2018 u vendos të pranohet propozimi i Njësies Kryesore.

Aktualisht, Programi i Studimeve Specializuese Afatgjata në “Ortognatodonci”, ofrohet i riorganizuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 18, datë 19.06.2018, me një total prej 180 ECTS, i shtrirë në 3 vite akademike dhe ku në fund të studimeve, në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimit (KSHK), specializanti pajiset me “Diplomë Specializimi” në “Ortognatodonci”.

Emërtimi i Diplomës. Për brezin e specializantëve 2012-2015 është lëshuar “Diplomë Specializimi në “Orthodonci” (“Specialization” in “Orthodontics”). Kjo diplomë është shoqëruar edhe me Supplementin e Diplomës bazuar mbi modelin e hartuar nga Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës dhe UNESCO/CEPES me qëllimin për të përmirësuar transparencën në shkallë ndërkombëtare të njohjes akademike dhe profesionale të kualifikimeve. Programi aktual ende nuk është akredituar si program dhe nuk janë lëshuar diploma.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof. Asc. Çeljana Toti

Prof. Asc. Etleva Droboniku

Ngritja e Grupit të Vlerësimin të Jashtëm (GVJ) është bërë nga ASCAL /Bordi i Akreditimit. Menaxheri teknik (MT) i ndjekjes së vlerësimin të kësaj procedure është specialisti i ASCAL, ME. Renata Qatipi.

Më datë 10.06.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 58/4 Prot., datë 10.06.2019 “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimin të Jashtëm”, AU është njohur me Draft-Raportin e vlerësimin të jashtëm.

Më datë 17.06.2019, AU përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft – Raportin e vlerësimin të jashtëm, me shkresë nr. 350/1Prot., datë 17.06.2019 “Kthim përgjigje shkresës nr. 58/4 Prot., datë 10.06.2019”.

Në këtë dokument institucioni është dakort me vlerësimin dhe nuk ka komente për Draft-RVJ. Draft Raporti është edhe Raporti përfundimtar.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA BORDI I AKREDITIMIT NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit me Vendim nr. 29, datë 19.05.2017:

- a. Të rritet numri i stafit akademik me kohë të plotë e tituj shkencorë dhe me specialistë të fushës specifike të programit me përvojë pune mbi 10 vjet.
- b. Duhet të rritet përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor.
- c. Duhet të shtohet bashkëpunimi me Institucionet të tjera të Arsimit të Lartë brënda dhe jashtë vendit.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a. Për rekomandimin “Të rritet numri i stafit akademik me kohë të plotë e tituj shkencorë dhe me specialistë të fushës specifike të programit me përvojë pune mbi 10 vjet”:


Është punuar me prioritet për të plotësuar detyrimet ligjore në lidhje me këtë rekomandim. Është rekrutuar staf akademik i kualifikuar, me tituj dhe grada. I gjithë personeli akademik që përfshihet në program ka eksperience pune të paktën 10 vjeçare dhe kanë specializim që i përket fushës akademiko-shkencore në përputhje me këtë program studimi (Tabela 1 ne aneks)

- b. Për rekomandimin “Duhet të rritet përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor”:

Institucioni ka përmirësuar ndjeshëm strategjitë për përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor. Gjatë vitit akademik studiohen topika të caktuara sipas edhe rasteve klinike të ndjekura nga vetë studentët nën kontrollin e tutorëve. Kjo i ka nxitur studentët të thellohen edhe më tepër në kërkimin shkencor duke shfrytëzuar literaturën në bibliotekën e Albanian University. Disa prej tyre i kanë prezantuar punimet e tyre në evente shkencore të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë si në Konferencën e XIV^{-të} Ndërkombëtare Stomatologjike, Konferencën Ndërkombëtare “21 Annual World Dental Summit”, Takimin e IV-t të Ortodontisë, etj. Gjithashtu për studentët është bërë i mundur mobiliteti i studentëve në kuadër të Erasmus for Young Entrepreneurs. Ata kanë qenë pjesë edhe e projekteve të realizuara si: “HERBST MENTOPATE” dhe “ESPANSORE RAPIDO ANCORATO A MINIVITI (MARPE)”. Albanian University duke fituar statusin e ofruesit të akredituar të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për Profesionistët e Shëndetësisë nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim, ka krijuar akoma më tepër mundësi për përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor.

- c. Për rekomandimin “Duhet të shtohet bashkëpunimi me Institucionet të tjera të Arsimit të Lartë brënda dhe jashtë vendit”:

Fakulteti i Shkencave Mjekësore pranë Albanian University ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me disa Universitetet Europiane si: Universitetin Federico II i Napolit me rrjetin e Universiteteve Mediterreanean and Middle East University, Universitetin e L'Aquilës, Universitetin e Pizës, Universitetin Aristotel të Selanikut, Fakultetin të Mjekësisë Dentare të Bukureshtit dhe të Iasit në Rumani, Universitetin Fernando Pessoa. Bashkëpunimi është thelluar edhe me institucione apo shoqatat e profesionistëve në vend si: Urdhëri i Stomatologut, Fakulteti i Mjekësisë Dentare, Shoqata Dentare Shqiptare, Shoqata e Ortodontëve Shqiptarë.



POLITIKAT E DREJTIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË STUDIMEVE TË SPA

1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit fokusohen në përgatitjen e specialisteve ortodonte, nëpërmjet një arsimit cilësor universitar ku ata të formohen jo vetëm profesionalisht, por edhe me vlera etike dhe njerëzore.

Objektivat specifike të programit janë të qarta dhe lidhen me plotësimin planit mësimor nëpërmjet leksioneve, praktikave mësimore, punës së pavarur me pacientët si edhe stimulimi i kërkimit shkencor nëpërmjet shfrytëzimit të literaturës, në përmbushje të qëllimit të vetë programit.

Objektivat specifike të programit lidhen me plotësimin planit mësimor nëpërmjet leksioneve, praktikave mësimore, punës së pavarur me pacientët si edhe stimulimi i kërkimit shkencor nëpërmjet shfrytëzimit të literaturës, në përmbushje të qëllimit të vetë programit. Studentët në përfundim të studimeve duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për të menaxhuar dhe trajtuar pacientët në nevojë për trajtim ortodontik.

Strategjia e zhvillimit të Programit të Studimit Afatgjatë në Ortognatodonci është përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit Fakulteti i Shkencave Mjekësore në Albanian University.

Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Organizimi i vitit mësimor. Plani mësimor përmbledhet qartë duke u ndarë me kreditet dhe orët mësimore. Për çdo vit akademik ofrohen 60 ECTS, duke patur një total prej 180 ECTS në fund të studimeve. Plani mësimor përmban të gjithë elementët e tij si lëndët, modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor dhe jashtë auditorit. Kurrikula mësimore për secilën lëndë përshkruan qartësisht mënyrën e organizimit të lëndës, literaturën dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, si edhe vlerësimin e studentit.

Organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë, kontrolli i njohurive të studentëve, udhëheqja shkencore e studentit, pershkruesh në rregulloren për specializimet dhe në syllabuset e lendeve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 1- Programet e studimeve specializuese afatgjata në mjekësi ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi: misioni dhe qëllimi i tyre është shprehur qartë.	
Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të specializimeve afatgjata është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Programi i studimit "Specializim afatgjatë në Ortognatodonci, është në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë në Shqipëri. Ai është organizuar në përputhje me udhëzimet e MASR ku lëndët, modulet vlerësohen me kredite ECTS. Institucioni Albanian University ka një mision të qartë në lidhje me programin e studimit që ofron. Duke krijuar një infrastrukturë të përshtatshme, duke ofruar një program ambicioz, institucioni tenton të krijojë mundësinë e një elite specialistësh të fushës me synimin për të përcjellë tek ata jo vetëm vlerat profesionale, por edhe njerëzore dhe humane. Brezit të ri i jepet një ndihmë në përmbushje të aspiratave të tyre dhe në aspektin e arsimit universitar ofrohet një
Kriteri 2 Institucioni ka një mision të qartë për programet e studimit që ofron.	
Kriteri 3 Qëllimi i programit të studimit dhe rezultatet që priten janë të qarta.	
Kriteri 4 Programet e studimit mbështeten mbi objektiva të qartë profesionale dhe janë të integruar me veprimtaritë klinike.	
Kriteri 5 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e përcaktuar nga Korniza	

Shqiptare e Kualifikimeve.	<p>dimension i ri me specifikat e veta.</p> <p>Programi i studimit Specializim afatgjatë në Ortognatodonci, ka si synim të qartë të tij përgatitjen e mjekeve stomatologe me njohuritë, kompetencat dhe kërkesat e tregut në lidhje me këtë specialitet.</p> <p>Programi ka objektiva të qarta për të përmbushur misionin e tij. Kjo realizohet nëpërmjet programit teorik dhe praktik.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimeve.</p>
----------------------------	---

Standardi I. 2- Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

<p>Kriteri 1 Programi i specializimit afatgjatë përfshin formim teorik e praktik në fushën e specialitetit, i cili realizohet njëkohësisht në një universitet të akredituar, dhe në një institucion spitalor ose në një institucion shëndetësor të aprovuar dhe akredituar për këtë qëllim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Ministria e Shëndetësisë (MSH) pasi është marrë mendimi i Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.</p> <p>Kriteri 2 Programi i specializimit afatgjatë kryhet me kohë të plotë dhe përfshin pjesëmarrjen në veprimtaritë mjekësore të departamenteve ose shërbimeve ku ofrohet formimi, në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe nën mbikqyrjen e autoritetit apo entit përgjegjës.</p>	<p>Programi i specializimit afatgjatë realizohet duke ndërthurur formimin teorik dhe praktik. Pjesa teorike e programit realizohet në auditoret e Fakultetit të Shkencave Mjekësore të AU i cili është një institucion i akredituar (akredituar me Vendim BA Nr. 90, datë 20.10.2017), kurse pjesa praktike e programit realizohet pranë Klinikës Universitare Stomatologjike e Licencuar me numrin serial: LN-4768-03-2018 si dhe në proces akreditimi nga QKCSAISH me shkresë Nr.184 Prot., date 08.06.2018.</p> <p>Programi i specializimit afatgjatë kryhet me kohë të plotë dhe përfshin pjesëmarrjen në veprimtaritë mjekësore të Departmentit të Stomatologjisë si edhe Klinekës Universitare Stomatologjike pranë AU. Të gjitha shërbimet ku ofrohet formimi, realizohen në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe nën mbikqyrjen e autoriteteve të përcaktuara me rregullore: përgjegjësi, kordinatori dhe udhëheqesi i programit.</p>
---	--

Standardi I. 3- Programet e studimeve janë eficente, në përputhje me misionin institucional.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni bën një planifikim institucional efikas dhe kryen përmirësime të ndjeshme për realizimin e qëllimeve dhe rezultojn se programi ka arritje të mira.</p>	<p>Programi i studimit në “Ortognatodonci” është në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit. Nëpërmjet objektivave të këtij programi synohet përvetësimi i metodave bashkëkohore të kërkimit shkencor dhe teknikve të trajtimit. Programi ka për qëllim formimin e përgjithshëm profesional të studentëve për specialitetin përkatës, poe edhe formimin e tyre me vlera morale dhe etike.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka kryer një planifikim institucional efikas dhe ka kryer përmirësime të ndjeshme për realizimin e qëllimeve. Strategjitë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjata të cilat janë të përcaktuara qarte si një guide praktike për të përmbushur objektivat e studimit. Programi i SPA në “Otognatodonci” është një shembull i përmirësimit të vazhdueshëm, duke respektuar lirinë akademike, por edhe duke respektuar aktet ligjore në fuqi.</p>
---	---

Standardi I. 4- Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare dhe integrojnë kërkimin shkencor.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë përshtaten në strukturë me programet homologe të zhvilluara në vendet europiane.</p>	<p>Programi i studimit afatgjata në Specialitetin “Ortognatodonci” përshtatet në strukturë me programet homologe të zhvilluara në vendet europiane. Treguesi kryesor i plotësimit të këtij kriteri, është organizimi i programit në kredite ECTS, me një shtrirje kohore në 3 vjet dhe ku në fund të programit grumbullohen 180 ECTS. Gjithashtu, në përshtatje me programet homologe që zhvillohen edhe</p>
--	--

Bele *06/7*

	në vendet e tjera evropiane, përqindjen më të madhe të orëve në kurrikul e zë pjesa klinike. I është dhënë rëndësi gjithashtu edhe plotësimit të pikave të marrëveshjeve me universitetet jashtë Shqipërisë duke planifikuar zhvillimin e moduleve të caktuara pranë klinikave universitare të tyre, apo mobilitetin e studentëve.
Standardi I. 5- Programet e studimeve ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve specializuere afatgjata në fushën e mjekësisë synojnë të plotësojnë kërkesat e tregut të punës në përputhje me nevojat për specialistë në fushën e mjekësisë.</p> <p>Kriteri 2 Numri i përgjithshëm i specializantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo vit përcaktohet në përputhje me politikat shtetërore të zhvillimit të fushës së shëndetësisë dhe kapacitetet pritëse të strukturave të përfshira në rrjetin formues (në varësi të numrit të personelit, kapaciteteve pritëse, etj).</p>	<p>Programi i specializimit afatgjatë në “Ortognatodonci” plotëson nevojat dhe kërkesat e tregut për specialist të fushës. Në këë specialitet, në asnjë institucion shtetëror, nuk është hapur një specializim afatgjatë që para viteve 90’.</p> <p>Numri i specializantëve pranë këtij programi është në përputhje me nevojën në rritje për trajtimin e anomalive dentare dhe skeletike, gjithashtu edhe në përputhje me kapacitetet institucionale dhe akademike që e ofrojnë këtë program.</p>
Standardi I. 14- Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor për vlerësimin e brendshëm.	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine, materiale mësimore të hartuara dhe të botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj.</p>	<p>Institucioni publikon rregullisht në faqen e ëeb-it raportin e vlerësimit të brendshëm, i cili përpilohet pas marrjes së informacioneve edhe nga NJSBC. Kjo zyre mbledh informacionin nga pyetësi on line që studentët plotësojnë dy herë në vit përkatësisht përparasezonit të provimeve. Gjithashtu është përpiluar edhe një booklet për vlerësimin e personelit akademik në institucion.</p> <p>Institucioni publikon rregullisht të gjitha aktivitetet akademike, shkencore, ekstrakurrikulare, etj nëpërmjet kanalit televiziv UTV.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>GVJ pas vizitës në institucion dhe njohjes me dokumentacionin përkatës konkludon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Programi i studimit SPA në “Ortognatodonci” pranë Albanian University ka një mision dhe objektiva të qarta. Ai synon përgatitjen e specialistëve të fushës me standarte të larta. Ai ofrohet i riorganizuar duke bërë përmirësime dhe ndryshime nën masën 20% në kurrikulën mësimore, edhe pse në thelb, kreditet dhe përmbajtja nuk ka ndryshime me kurrikulën e brezit 2012-2015 dhe 2014-2017. - Programi ofrohet pranë një institucioni arsimor të akredituar (Albanian University) si edhe i mbështetur nga Klinika Universitare Stomatologjike e cila është e licensuar dhe në pritje të procesit të akreditimit. - Programi ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës në kushtet kur nevoja për trajtim ortodontik është në rritje, ndërkohë që numri i specialisteve ortodontë është ende shumë i vogël në Shqipëri. - Institucioni realizon rregullisht vlerësimin e brendshëm dhe e publikon në faqen zyrtare të tij. Gjithashtu nëpërmjet kanalit televiziv UTV publikohen të gjitha aktivitetet shkencore, akademike dhe ekstrakurrikulare të zhvilluara nga Albanian University. 	

2. Struktura akademike e Fakultetit /Departamentit që ofron SPA

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Programi i studimit në “Ortognatodonci” zhvillohet pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Albanian University i cili ka organet drejtuese, autoritetet drejtuese, njësitë bazë mësimore-shkencore dhe administratën.

Njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore janë 3 departamente:

- a. Departamenti i Stomatologjisë
- b. Departamenti i Farmacisë
- c. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë

Njësi ndihmëse dhe shërbimi në funksionimin e Departamentit të Stomatologjisë është Klinika Stomatologjike Universitare

Personeli akademik përbëhet nga pedagogët me kohë të plotë ose të pjesshme, si dhe personeli akademik i ftuar.

Personeli ndihmës-akademik:

- a) me karakter mësimor
 - Asistentët e Departamenteve
 - Asistent pedagogët e praktikave mësimore
 - Laborantët.
- b) Me karakter administrativ
 - Sekretaret e sekretarisë mësimore.

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit afatgjatë në “Ortognatodonci” është Departamenti i Stomatologjisë. Në këtë departament numri i personelit akademik efektiv (PAE) është 32, kurse numri i personelit akademik me kontratë (PAK) është 16 (Tabela 1, në aneks).

Këshilli i Profesorëve të Fakultetit përbëhet nga 5 anëtarë ndër të cilët 4 anëtarë me titullin Profesor dhe 1 anëtar me Phd dhe që mjekohësisht është edhe Koordinator i Programit (Tabela 2, në aneks).

Organet drejtuese të Programit të studimit Specializim afatgjatë në “Ortognatodonci” janë:

1. Këshilli Drejtues
2. Drejtuesi i programit të specializimit
3. Udhëheqësi akademik/klinik
4. Koordinator i Programeve të Specializimeve.

Tregues të matshëm:

Organigrama e Fakultetit

Fakulteti Shkencave Mjekësore si organe drejtuese ka: Dekanatin dhe Asamblenë e Personelit Akademik, kurse si organ drejtues administrativ ka Administratorin e Fakultetit. Në këtë fakultet ka 3 departamente: Departamenti i Stomatologjisë, Departamenti i Farmacisë dhe Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë. Secili departament ka Përgjegjësin e Departamentit.

Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (Tabela 1, në aneks)

- Në Departamentin e Stomatologjisë janë angazhuar 32 pedagogë nga të cilët PAE: 1 pedagog është me titullin Profesor, 1 Profesor i Asociuar, 13 me Phd, 8 SPA dhe 9 Msc.

Gjithashtu janë angazhuar 19 pedagogë si PAK: 3 janë me titullin Profesor, 3 Profesor i Asociuar, 6 Doktor, 2 SPA dhe 5 Msc. Raporti PAE/PAK është 32/19.

- Në Departamentin e Farmacisë janë angazhuar 21 pedagogë nga të cilët PAE: 2 pedagogë janë me titullin Profesor, 10 profesorë janë me gradën Dr/Phd, 9 profesorë janë me kualifikimin Msc.

Gjithashtu janë angazhuar 11 pedagogë si PAK: 3 pedagogë janë me titullin Profesor, 4 pedagogë janë Profesor i Asociuar, 1 pedagog me Dr/Phd, 2 pedagogë janë me kualifikimin Msc si edhe 1 Profesor i ftuar. Raporti PAE/PAK është 21/11.

- Në Departamentin e Infiermierisë dhe Fizioterapisë janë angazhuar 32 pedagogë nga të cilët PAE: 1 pedagog është Akademik, 1 pedagog me titullin Profesor, 2 janë Profesor i Asociuar, 6 janë me gradën Dr/Phd, 2 janë me kualifikimin SPA dhe 20 pedagogë janë me kualifikimin Msc.

Gjithashtu janë angazhuar 17 pedagogë si PAK: 2 pedagogë janë me titullin Profesor, 3 janë me titullin Profesor i Asociuar, 6 pedagogë janë me gradën Dr/ Phd, 1 SPA dhe 5 Msc. Raporti PAE/PAK është 32/17.

Në të tre departamentet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore pranë Albanian University është rekrutuar personel akademik me tituj dhe grada.

- Strukturat e akredituara (Njësi kryesore/njësi bazë) të vetë institucionit që ofron SPA

Programi Specializim Afatgjatë në “Ortognatodonci” zhvillohet pranë Albanian University i cili është një institucion i akredituar me Vendim BA Nr. 90, datë 20.10.2017.

- Strukturat me të cilat janë bërë marrëveshje¹. Për realizimin e këtij programi studimi si Njësi Ndhmëse e Departamentit të Stomatologjisë për zhvillimin e praktikave mësimore është vënë në dispozicion Klinika Universitare Stomatologjike “Çerçiz Mingomataj”. Gjithashtu në kontratat e bashkëpunimit me Universitetet Evropiane, është parashikuar që module të caktuara të zhvillohen pranë klinikave të tyre.

- Dokumentacioni përkatës: organigrama, lista e pedagogëve, rregulloret,

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II. 1- Personeli akademik dhe administrativ organizohet për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit.	
Kriteri 1 Struktura akademike dhe administrative e institucionit përmbush objektivat e programeve të studimit dhe objektivat strategjikë për zhvillimin e institucionit.	Struktura akademike dhe administrative e institucionit përmbush objektivat e programeve të studimit dhe objektivat strategjikë për zhvillimin e institucionit. Stafit akademik është me tituj dhe grada shkencore, me eksperiencë mbi 10 vjeçare dhe një numër i konsiderueshëm i tyre vjen nga Universitetet Evropiane. Personeli administrative është në ndihmë të procesit mësimor duke lehtësuar, por edhe përmirësuar cilësinë e mësimdhënies.
Standardi II. 2- Organizimi i institucionit është në përputhje me përcaktimet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në përmbushje të misionit të tij.	
Kriteri 1 Organizimi i institucionit bëhet në përmbushje të misionit dhe qëllimit të tij. Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete një nga të cilët ofron studime në fushën e mjekësisë së paku për programet e integruara të studimeve në fushën e Mjekësisë, Farmacisë dhe Stomatologjisë. Kriteri 3 Fakulteti ose Qendra Kërkimore	Organizimi i institucionit bëhet në përmbushje të misionit dhe qëllimit të tij. Institucioni 3 Fakultete: - Fakulteti i Shkencave Mjekësore - Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike - Fakulteti i Shkencave Shoqërore.

¹ (Në rastet kur programi i studimit parashikon frekuentimin e strukturave, shërbimeve, aktiviteteve, laboratorëve ose gjithçka tjetër që nuk bën pjesë në strukturën qendrore/bazë ose në strukturat dytësore të lidhura me të, institucioni që ofron programin e studimit lidh një kontratë ose konvencion me këto struktura komplementare. Në këto raste duhet të ketë marrëveshje të veçanta mes IAL-së dhe strukturës në fjalë dhe të respektohen standardet e parashikuara për strukturat qendrore/bazë e dytësore).

<p>Shkencore janë të përbëra, së paku, nga 3 shërbime/departamente me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar.</p>	<p>Nga këto fakultete, ai i cili ofron studime në fushën e mjekësisë së paku për programin e integruar në Stomatologji, është Fakulteti i Shkencave Mjekësore.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka 3 departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Stomatologjisë - Departamenti i Farmacisë - Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë. <p>Njësi ndihmëse e Departamentit të Stomatologjisë - Klinika Stomatologjike Universitare “Çerçiz Mingomataj”.</p>
---	---

Standardi VII. 1- Rregullorja është hartuar në përputhje me standardet e specializimeve në mjekësi dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe përditësohet çdo vit akademik


<p>Kriteri 1 Rregullorja është hartuar në përputhje me standardet e specializimeve në mjekësi dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Rregullorja hyn në fuqi në fillim të çdo viti akademik dhe përditësohet çdo vit të ri akademik.</p> <p>Kriteri 3 Kriteret e përcaktuara për një cikël specializimi në fillim të tij nuk mund të ndryshojnë gjatë përditësimeve vjetore të rregullores deri në përfundim të atij cikli. Nëse janë të nevojshme, ndryshimet në rregullorët pasardhëse duhet të përjashtojnë shprehimisht ciklin e nisur të specializimit.</p>	<p>Rregullorja e Programit të Studimit Specializim Afatgjatë në “Ortognatodonci” është hartuar në përputhje me standardet e specializimeve në mjekësi dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Ajo mbështetet në Ligjin nr.80/2015, “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe në të gjitha aktet normative që dalin në zbatim të ligjit, gjithashtu dhe në Statutin dhe Rregulloren e Institucionit.</p> <p>Kjo rregullore është përditësuar me Vendim Senati Nr. 5 Datë 28.02.2018. Ajo hyn në fuqi në fillim të çdo viti akademik dhe përditësohet çdo vit të ri akademik.</p> <p>Studentët njihen me rregulloren që në fillimin e programit dhe deri në fund të ciklit 3 vjeçar të studimeve ata janë të detyruar ta respektojnë atë.</p>
--	--

Standardi VII. 2- Hartimi dhe miratimi i rregullores ndjek procedurat dhe merr mendimin e institucioneve të ndryshme të parashikuara për këtë qëllim.

<p>Kriteri 1 Rregullorja propozohet nga Këshilli i Profesorëve dhe aprovohet nga senati i institucionit që i ofron ato.</p> <p>Kriteri 2 Rregullorja e aprovuar nga senati merr aprovimin nga MSH dhe MASH para hyrjes në fuqi.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit pasi ka marrë vlerësimin e strukturave përkatëse që preken nga ndryshimi i propozuar, është miratuar me Vendim Senati Nr.5, me Nr.88/4 Prot, datë 28.02.2018.</p>
---	--

Standardi VII. 3- Rregullorja përcakton kriteret dhe mënyrën e përzgjedhjes së organeve drejtuese të programeve specializuese dhe tutorëve.

<p>Kriteri 1 Në rregullore janë përcaktuar qartë kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së përgjegjës të programit të specializimit dhe të këshillit drejtues.</p> <p>Kriteri 2 Në rregullore përcaktohen kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së mjekut përgjegjës/tutor për çdo specializant si dhe detyrat e tij.</p>	<p>Konform kriterëve ligjore në fuqi. Përgjegjës i këtij programi studimi, është Prof.Anesti Kondili i cili është Akademik dhe ka një eksperiencë të gjatë akademike dhe profesionale.</p> <p>Gjithashtu Këshilli Drejtues është organ kolegjal, i cili është ngritur në nivel njësie kryesore dhe ka në përbërjen e tij 5 (pesë) pedagogë me kohë të plotë dhe jo më pak se 2 (dy) pedagogë për çdo program studimi. 4 nga anëtarët janë me titullin “Profesor” dhe 1 anëtar me Phd në Universitet European dhe i cili është edhe Koordinator i programit.</p> <p>Të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues kanë një eksperiencë pune mbi 10-vjeçare.</p> <p>Në rregullore është e përcaktuar qartë mënyra e përzgjedhjes së përgjegjës të programit (neni 15 dhe 16, Rregullorja e programit të studimit).</p>
--	--



	Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së mjekut përgjegjës/tutor për çdo specializant si dhe detyrat e tij (neni 17 dhe 21). Udhëheqësi i programit ka një eksperiencë profesionale mbi 10-vjeçare me përvojë klinike në Ortognatodonci. Udhëheqësi propozon tutorët që gjithashtu duhet të kenë një eksperiencë profesionale mbi 10-vjeçare, ai planifikon pacientët, përcakton grupet e punës, etj.
--	---

Standardi VII. 4- Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra e pranimit të studentëve në programin e specializimit

<p>Kriteri 1 Në rregullore janë përcaktuar kriteret për aplikim (niveli i studimeve të kryera, kohëzgjatja dhe titulli i diplomës që kërkohet, nota mesatare, moshë, publikimet e kryera, etj) si dhe kriteret përjashtuese.</p> <p>Kriteri 2 Në rregullore përcaktohet qartë dokumentacioni që duhet të dorëzojë kandidati për aplikim, mënyra e dorëzimit të dokumentacionit dhe afati përfundimtar.</p> <p>Kriteri 3 Në rregullore janë përcaktuar qartë pikët maksimale që mund të grumbullojë kandidati dhe pikët që i jepen kandidatit për çdo kriter të plotësuar (notë mesatare, publikime, etj) si dhe pikët maksimale dhe minimale që mund ti jepen kandidatit gjatë çdo testimi (me shkrim, me gojë, praktik, etj).</p> <p>Kriteri 4 Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e konkurimit dhe si duhet të aplikojë kandidati për specializim; përcaktohet sa kohë para datës së shpallur për testimet mbyllet pranimi i dokumentave.</p> <p>Kriteri 5 Aplikanti dorëzon një kërkesë me shkrim sipas formatit të përcaktuar në rregullore dhe që i bashkangjitet asaj. Aplikantit, në momentin e pranimit të dokumentacionit i jepet një vërtetim për aplikimin me numrin e tij identifikues gjatë procesit.</p> <p>Kriteri 6 Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra e zhvillimit të testeve, rradha e zhvillimit të tyre, sa ditë diferencë mund të ketë nga një testim tek tjetri për të njëjtin program dhe për programe të ndryshme specializimi.</p> <p>Kriteri 7 Në rregullore përcaktohet mënyra e përzgjedhjes së komisionit të provimit dhe kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e komisionit.</p> <p>Kriteri 8 Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e vlerësimit të kandidatëve për çdo testim dhe dokumentacioni i përdorur i cili ruhet sipas procedurave të parashikuara në rregullore.</p> <p>Kriteri 9 Emërtimet e programeve të specializimeve të miratuara për vitin akademik, numri i specializantëve që do të pranohen për çdo program specializimi dhe taksat që duhet të paguajë specializanti për çdo specializim publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.</p> <p>Kriteri 10 Mënyra e vlerësimit dhe argumentet mbi të cilat kryhet testimi duhet të përcaktohen në rregullore dhe të publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.</p> <p>Kriteri 11 Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra dhe afatet e shpalljes së rezultateve të testeve dhe të listës përfundimtare me fituesit si dhe</p>	<p>Në rregullore janë përcaktuar kriteret për aplikim si edhe kriteret përjashtuese sipas vendimit të Senatit Akademik në përputhje me legjislacionin në fuqi. Të gjithë studentët që aplikojnë duhet të kenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mesatare mbi notën 6 - të kenë një diplomë “Msc (PI) në Stomatologji” ose një diplomë ekuivalente më të (e njehësuar nga MASR), - dëshminë e njohjes së një gjuhe të huaj (pika 3, neni 78, ligji 80/2015), - të ketë dhënë provimin e shtetit sipas ligjit 1017 datë 22.10.2009. - Çdo aplikant duhet të dorëzojë gjithashtu edhe CV-në për të pasqyruar aktivitetin profesional. <p>Në rregullore përcaktohet qartë dokumentacioni që duhet të dorëzojë kandidati për aplikim, mënyra e dorëzimit të dokumentacionit dhe afatet.</p> <p>Në rregullore janë përcaktuar qartë pikët maksimale që mund të grumbullojë kandidati dhe pikët që i jepen kandidatit për çdo kriter të plotësuar. Pikët maksimale janë 100 nga të cilat me 50 vlerësohet intervista me gojë, 30 pikë aktivizimi i aspirantit në aktivitete që lidhen më fushëm dhe 20 pikë mesatarja.</p> <p>Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e konkurimit dhe si duhet të aplikojë kandidati për specializim:</p> <p>Njoftimi për konkursin bëhet të paktën 2 javë përpara datës së përcaktuar dhe në mënyrë publike nëpërmjet faqes zyrtare të ueb-it të të universitetit;</p> <p>Aplikanti plotëson një kërkesë me shkrim sipas formatit të hartuar nga institucioni. Menjëherë pajiset me një vërtetim për aplikimin e kryer. Ai dorëzon dokumentacionin e nevojshëm pranë sekretarisë së programit.</p> <p>Në rregullore është përcaktuar qartë mënyra e zhvillimit të konkursit:</p> <p>Në rregullore përcaktohet mënyra e përzgjedhjes së komisionit të provimit dhe kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e komisionit. Komisioni përbëhet nga ekspertë të fushës dhe miratohet nga Dekani.</p> <p>Njoftimi në lidhje me hapjen e këtij program, emërtimin e tij, numri i specializantëve që do të pranohen dhe taksat që duhet të paguajë specializanti, për programin e specializimit afatgjatë në “Ortognatodonci” është bërë 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve (28.09.2019).</p> <p>Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e vlerësimit të kandidatëve për çdo testim dhe dokumentacioni i përdorur i cili ruhet sipas procedurave të</p>
---	--

Bele *og*

<p>është përcaktuar vendi dhe data e shpalljes së rezultateve.</p> <p>Kriteri 12 Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e lidhjes së kontratës me specialistët fitues.</p>	<p>parashikuara në rregullore.</p> <p>Fitues shpallen kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të pikëve në rend zbritës deri në plotësimin e kuotës së parashikuar të pranimit.</p> <p>Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e lidhjes së kontratës me specialistët fitues. Aplikanti fiton statusin e specialistit me përfundimin e procedurave të regjistrimit e përcaktuar kjo në nenin 26, 27, 28 të rregullores programit studimit.</p>
---	---

Standardi VII. 5- Në rregullore parashikohen plani i çdo programi specializues, frekuentimi i tyre, transferimet e studenteve.

<p>Kriteri 1 Plani i detajuar i çdo programi specializues, lëndët dhe praktikat që duhet të frekuentohen, mënyra e frekuentimit, maksimumi i mungesave të lejuara dhe arsyet, leja e lindjes, dhe mënyra e recuperimit të mungesave duhet të jenë të parashikuara në rregulloren e specializimeve.</p> <p>Kriteri 2 Parashikohen procedurat për transferimet për apo nga programe të tjera specializuese, ose për apo nga institucione të tjera që ofrojnë programe specializuese në mjekësi.</p> <p>Kriteri 3 Parashikohen kriteret dhe mënyra e pezullimit, zgjatjes ose përjashtimit të specialistit nga studimet specializuese.</p> <p>Kriteri 4 Rregullorja parashikon rastet kur specializimi mund të kryhet në një institucion tjetër që nuk është pjesë e rrjetit formues (për shembull institucionet jashtë vendit), kohëzgjatjen e kësaj periudhe dhe organin aproves të kësaj procedure. Këto institucione duhet të jenë të akredituara për kryerjen e programit specializues në vendin përkatës.</p>	<p>Në Rregulloren e Programit të Studimit Specializim Afatgjatë në Ortognatodonci pasqyrohet i gjithë plani mësimor i detajuar, i ndarë në praktikat klinike, seminare apo leksione. Një student nuk mund të kalojë në vitin pasardhës akademik nëse nuk ka marrë të paktën 50% të lëndëve të vitit që ka frekuentuar. Në raste të tilla ai mbetet në stash dhe gjatë stazhit ai i rifrekuenton këto lëndë duke hyrë në sezonet përkatëse të provimeve.</p> <p>Sipas Rregullores së Regjistrimeve dhe Transferimeve, Albanian University mundëson transferimin e specialistëve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të tretë, midis programeve të njëjta ose të ngjashme studimi, si brenda të njëjtit Institucion apo Institucioneve të ndryshme të Arsimit të Lartë, private ose publike, vendase ose të huaja, si dhe lejon transferimin e specialistëve të saj në shkolla të tjera të arsimit të lartë sipas procedurave të parashikuara në këtë rregullore, nëse këto institucione janë të akredituara për kryerjen e programit specializues në vendin përkatës.</p> <p>Rregullorja e Përgjithshme dhe Kodi i Etikës së Institucionit parashikon kriteret dhe penalitetet në rast të caktuara ku student mund të pezullohet apo edhe përjashtohet nga studimet specializuese. Rregullorja përcakton qartë se studimet nuk mund të zgjasin më shumë se dyfishin e kohës së vetë programit.</p> <p>Rregullorja e Programit të Studimit Specializim Afatgjatë në Ortognatodonci parashikon se zhvillimi i programit mund të realizohet në një institucion jashtë rrjetit formues. Për këtë arsye janë realizuar kontrata bashkëpunimi me disa Universitete Evropiane.</p>
--	--

Standardi VII. 6- Në rregullore parashikohet librezja e studentit, tipologjia dhe mënyra e verbalizimit të rezultateve të provimeve.

<p>Kriteri 1 Rregullorja parashikon formatin e librezës së studentit, mënyrën e plotësimit të saj dhe mënyrën e zëvendësimit të saj në rast humbje. Libreza e studentit e shoqëron atë deri në përfundim të ciklit specializues dhe diplomimit të tij.</p> <p>Kriteri 2 Përcaktohen tipologjia dhe mënyra e verbalizimit të rezultateve të testeve të kryera për pranimin e kandidatëve, testeve vjetore dhe testimi përfundimtar.</p>	<p>Në rregulloren e Programit të Studimit Specializues Afatgjatë në Ortognatodonci parashikohet kartela klinike ku regjistrohen të gjitha punimet e realizuara nga studentët. Gjatë vizitës në institucion, konfirmuam se të gjithë studentët ishin të pajisur me një librezë personale.</p> <p>Kjo librezë e shoqëron studentin deri në përfundim të ciklit specializues dhe diplomimit të tij. Libreza plotësohet nga specialisti pas çdo procedure të kryer mbi pacientin dhe firmoset nga tutorët klinikë pas evidentimit të punimeve të kryera. Udhëheqësi i programit të Specializimit ka të ruajtur në sistem digital të dhënat e secilit prej specialistëve dhe punimet e realizuara prej tyre. Këto të dhëna u kontrolluan gjatë vizitës në institucion dhe përputheshin me ato të përshkruara në librezën e specialistit.</p>
--	---

	Vlerësimi final për një lëndë të caktuar bëhet me provim. Rezultatet shpallen nga sekretaria mësimore dhe hidhen në portalin on-line i cili është i hapur për studentet duke ruajtur të dhënat personale.
--	---

Standardi VII. 7- Në rregullore parashikohen procedurat për testimet vjetore dhe testimin përfundimtar si dhe formati i diplomës.

<p>Kriteri 1 Në rregullore përcaktohet mënyra e testimit vjetor dhe përfundimtar të specialistëve, pikët minimale dhe maksimale, lloji i testit dhe argumentet që testohen.</p> <p>Kriteri 2 Në rregullore përcaktohen kriteret për përzgjedhjen e komisionit të testimit vjetor dhe të atij përfundimtar.</p> <p>Kriteri 3 Në rregullore përcaktohen rastet e mungesave të justifikuara në teste dhe mënyra e recuperimit të testimit në këto raste.</p> <p>Kriteri 4 Në rregullore përcaktohet formati i diplomës. Diploma duhet të firmoset nga rektori, kryetari i komisionit të provimit përfundimtar/final dhe dekani i fakultetit përkatës.</p>	<p>Rregullorja e programit Studimit, neni 34 përcakton mënyrën e vlerësimit provimeve të lëndëve gjatë çdo viti të specializimit: shprehet sipas Sistemit Kombëtar të vlerësimeve me nota nga 4 deri te 10, ku 4 konsiderohet notë jo kaluese, 5 është nota më e ulët kaluese dhe 10 nota maksimale dhe sipas vlerësimit me sistemin me nota ECTS ku nota më e ulët kaluese është E dhe nota më e lartë është A. Modulet teorike vlerësohen me teste me shkrim për kursin e integruar në përfundim të çdo semestri, ku do të testohen njohuritë teorike të përfuara gjatë semestrit. Në përfundim të çdo semestri kryhet vlerësimi i praktikës klinike në bazë të ndërhyrjeve që specialisti ka zhvilluar gjatë vitit akademik. Përgjegjës dhe vlerësues kryesor për praktiken klinike është udhëheqësi i programit të studimit. Ai bazohet në regjistrimin e aktiviteteve klinike, në sjelljen e specialistëve si operator primar, i dytë apo i tretë, në punën në grup, në sjelljen etike të specialistit ndaj pacientit, kolegeve dhe stafit që organizon programin e specializimeve.</p> <p>Komisioni i vlerësimit propozohet nga Drejtuesi Programit të Specializimit dhe miratohet nga Dekani i FShM.</p> <p>Në rregulloren e programit studimit neni 34 pika 1: Frekuentimi i aktiviteteve formuese në auditor është i detyrueshëm në masën 75%. Studenti nuk pranohet në sesionin e parë të provimit të një lënde kur ka kryer më shumë se 25% mungesa në seancat mësimore të asaj lënde. Nëqoftëse ai ka kryer deri në 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës, atëherë ai pranohet në sesionin e dytë. Nëse ka kryer mbi 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës shpallet përsëritës në atë lëndë dhe kalon në stash për ta ndjekur këtë lëndë në vitin pasardhës akademik. Shlyerjet e orëve praktike mund të kryhen nën mbikqyrjen e tutorëve përgjatë ditëve të javës duke punuar me pacientë.</p> <p>Formati i Diplomës miratohet nga MASR pas akreditimit të programit.</p>
--	--

Standardi VII. 8- Në rregullore parashikohen të drejtat dhe detyrat e specialistit.

<p>Kriteri 1 Rregullorja duhet të përmbajë detyrat dhe të drejtat që ka specialisti.</p> <p>Kriteri 2 Në rregullore përcaktohet tipologjia dhe mënyra e sigurimit të specialistëve gjatë kryerjes së specializimit. Parashikohet tipi i policës së sigurimit dhe masa e mbulimit.</p> <p>Kriteri 3 Në planin e programeve të specializimeve parashikohet se kur mund të kryhen veprimtari të caktuara të parashikuara nga këto programe, në ç'gradë autonomie mund të kryhen dhe çfarë aktiviteteve duhet të ketë kaluar me sukses specialisti për të zhvilluar disa aktivitete të tjera të parashikuara nga programi specializues, nën mbikqyrje ose në autonomi të plotë. Është përcaktuar një sistem vartësish të aktiviteteve të parashikuara.</p> <p>Kriteri 4 Parashikohen rastet kur mund të pezullohet specializimi nga ana e specialistit dhe</p>	<p>Rregullorja e SPA përmban detyrat (neni 47, 48) dhe të drejtat (neni 44) që ka specialisti.</p> <p>Specializantët e SPA në "Ortognatodonci" janë të siguruar sipas një police të sigurimit falë marrëveshjeve të institucionit me kompani të sigurimit.</p> <p>Përveç detyrimeve akademike që lidhen me frekuentimin e lëndëve, studenti është i detyrur të plotësojë një numër të caktuar pacientësh të trajtuar apo të ndjekur nga ai si një detyrim për të hyrë në provimin final të specializimit.</p> <p>Për arsye të caktuara specialisti mund të kërkojë pezullimin e specializimit, por gjithsesi në total koha nga nisja e specializimit deri në përfundimin e studimeve nuk mund të jetë më e gjatë se dyfishi I kohëzgjatjes normale të programit. Nëse specialisti kërkon të heqë dorë</p>
--	---

periudha maksimale e lejuar për pezullim, si dhe procedurat për të hequr dorë nga specializimi.

nga specializimi, rregullorja e parashikon procedurën që duhet të ndiqet.

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ pas vizitës në institucion dhe njohjes me dokumentacionin përkatës konkludon:

- Institucioni disponon një rregullore e cila është hartuar në përputhje me stantartet e specializimeve në mjekësi si edhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kjo rregullore është e miratuar me vendim senati dhe përcakton qartë mënyrën e perzgjedhjes së organeve drejtuese.
- Në rregullore përcaktohet mënyra e pranimit të studentëve. I jepet prioritet intervistës me goje dhe nuk aplikohet provim me shkrim. Të interesuarit mund të gjejnë informacion në lidhje me zhvillimin e konkursit pranues nëpërmjet njoftimit të shpallur në faqen zyrtare të institucionit. Për fituesit, në institucion ruhet i gjithë dokumentacioni i dorëzuar fillimisht dhe dosja plotësohet me të dhëna nga CV-ja e studentit përgjatë ndjekjes së programit.
- Studentët pajisen me librezën personale sipas një formati të parashikuar në rregullore. Në këtë librezë ata në mënyrë të vazhdueshme hedhin të dhëna në lidhje me punën klinike të kryer me pacientët.
- Rregullorja është e qartë në lidhje me detyrimet dhe të drejtat e studentit.
- Parashikohen mënyrat e shlyerjes së detyrimeve akademike sikundër edhe rastët e pezullimit apo ndërprerjes së plotë të studimeve.

3. Personeli akademik dhe ai mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik të SPA, raporti PAE/PAK, Personel akademik/Personel administrativ/student; shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Në Albanian University në fillim të cdo viti akademik, Njësia bazë i përcjell Dekanatit të Fakultetit të Shkencave Mjekësore nevojat për personel akademik. Ky i fundit ia përcjell Rektorit i cili përcakton kriteret për rekrutimin e personelit akademik. Procedura ndiqet në zbatim të rregullores së institucionit e cila parashikon një thirrje të hapur për vendet vakante, zhvillimin e një konkursi për aplikantët si edhe një periudhe prove prej 3 muajsh në mbarim të së cilës përcaktohet përfundimisht nëse marrëdhënia e punës do të vazhdojë apo do të ndërpritet.

Në programin e specializimit afatgjatë në “Ortognatodonci” është rekrutuar staf akademik vendas dhe i huaj me tituj “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose gradë shkencore “Doktor” apo “PHD” të fituar në universitete të njohura në botë. Gjithashtu të gjithë tutorët e përfshirë në program kanë diplomë specializimi në përshtatje me karakterin specializues të programit.

Në kontratën e punës përcaktohet marrëveshja ndërmjet punëmarrësit dhe institucionit si punëdhëns dhe në aneksin e kontratës pasqyrohet edhe ngarkesa mësimore për secalin pedagog.

Tregues të matshëm:

- Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Tabela 4, në aneks)

Në programin e specializimit afatgjatë për “Ortognatodonci” pranë Albanian University, numri i PAE është 16 dhe PAK është 13. Personeli akademik është me tituj “Profesor”, “Profesor i Asociuar”, “Doktor” me Phd të mbrojtura në Universitetet Europiane, apo kanë diploma specializimi në përshtatje me programin e studimit. Personeli akademik i përfshirë në program ka një eksperiencë pune jo më pak se 10 vjeçare.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 5, në aneks)

Në këtë program studimi janë: 8 pedagogë me titullin “Profesor”, nga të cilët 4 PAE dhe 4 PAK, në total 4 të huaj dhe 4 vendas; 3 pedagogë me titullin “Profesor i Asociuar”, të gjithë vendas, nga të cilët 1 PAE dhe 2 PAK; 10 pedagogë ose tutorë me Phd të mbrojtur në Universitetet Evropiane nga të cilët 6 PAE dhe 4 PAK, 8 vendas dhe 2 të huaj. Vihet re përfshirja si tutor e personelit të specializuar në këtë specialitet apo në disiplina të përfshira në program.

Të dhëna sipas moshës (Tabela 6, në aneks)

Numri i personelit akademik me titullin “Profesor” për moshën 56-65 vjeç është 4 (raporti PAE/PAK është 3/1), kurse për moshën 66-68 vjeç është 1(PAE).

Numri i personelit akademik me titullin “Profesor i Asociuar ” për moshën 45-55 vjeç është 3 (raporti PAE/PAK është 1/2).

Numri i personelit akademik me Phd të mbrojtur në Universitetet Evropiane për moshën 36-45 vjeç është 9 (raporti PAE/PAK është 6/3), kurse për moshën 46-55 vjeç është 1(PAK).

Në përgjithësi tek personeli akademik mbizotëron mosha 36-45 vjeç.

Në kategorinë “Profesor” personeli akademik është mbi 56 vjeç, ndër këta 4 PAE dhe 1 PAE.

Në kategorinë “Profesor i Asociuar” personeli akademik është nën moshën 55 vjeç.

Personeli akademik me Phd të mbrojtura në Universitetet Evropiane është i një moshe të re, nën 45 vjeç.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Për secilin anëtar të personelit akademik përpilohen kontratat e punës në të cilën përpilohen të drejtat dhe detyrimet, si edhe Aneksat e kontratës ku parashikohet ngarkesa mësimore.

Në Albanian University aplikohen kontrata të bazuara në Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë si edhe në Kodin e Punës, përkatësisht:

- Kontrata me afat të pacaktuar për stafin akademik me kohë të plotë për të gjitha kategoritë profesor/lektor/asistent-lektor
- kontrata me afat të pacaktuar për stafin akademik me kohë të pjesshme për kategoritë profesor dhe lektor, ndërsa për kategorinë asistent-lektor kontrata me afat të caktuar.
- Inviting profesor - për kategorinë e profesorëve të ftuar, në fushën e programit specializues.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III. 2 - Strukturat e përfshira duhet të disponojnë standardet e përgjithshme dhe specifike të parashikuara	
Kriteri 5 IAL-të duhet të komunikojnë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të gjitha ndryshimet e kriterëve dhe standardeve që kanë mundësuar akreditimin jo më vonë se 30 ditë nga ndryshimi. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës ekzaminojnë kriteret dhe standardet e ndryshuara dhe japin miratimin e tyre mbi këto ndryshime.	Kurrikula mësimore e programit është riorganizuar me Vendim Senati Akademik Nr.18, datë 19.06.2018 nën masën 20% dhe është pranuar nga MASR me shkresë Nr. 2635/1 Prot datë 19.07.2018.
Kriteri 6 Institucioni që ofron programet specializuese	Albanian University ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ të cilët janë vënë në dispozicion të realizimit të programit. Numri i tyre është 18 dhe nga këtë 10 janë personel me kohë të plotë, kurse 8 janë me kontratë. Mund

<p>ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ kompleksiv në strukturat qendrore dhe dytësore për të mbuluar nevojat e specialiteteve të ofruara, në bazë të kapaciteteve.</p> <p>Kriteri 7 Institucioni që ofron programet specializuese është i mirëorganizuar dhe disponon dokumentacion që tregon mënyrën e organizimit dhe strukturën drejtuese si dhe personelin administrativ dhe akademik me titujt përkatës si dhe rolet e parashikuara për secilin.</p>	<p>të përmendim sekretarine mësimore, mjekët e sallave klinike, infermierët, etj.</p> <p>Albanian University i cili ofron këtë program studimi, është i organizuar në përputhje me aktet normative të Institucionit si dhe me strategjinë për zhvillim të insitucionit. Rregullorja e Programit të studimit si edhe Rregullorja e Klinikës Stomatologjike Universitare “Çerçiz Mingomataj” si pjesë e rëndësishme e klinike e programit, parashikojnë strukturat dhe detyrat e personelit.</p>
--	--

Standardi III. 3 - Rrjeti formues² plotëson kriteret minimale të parashikuara dhe është i përshtatshëm për të ofruar programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.

<p>Kriteri 1 Institucioni plotëson kërkesat minimale të përgjithshme të parashikuara në këtë dokument përsa i përket rrjetit formues.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni duhet të plotësojë kërkesat minimale specifike për çdo specialitet të parashikuara në shtojcën 2 të këtij dokumenti përsa i përket rrjetit formues.</p> <p>Kriteri 3 Kërkesat e përgjithshme dhe specifike janë të organizuara sipas kriteve të mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> Përshtatshmëria e strukturave dhe pajisjeve, me shërbimet përkatëse të përgjithshme dhe diagnostikuese dhe ekzistencën në to të specialiteteve të ngjashme Ekzistenca e numrit dhe procedurave praktike të mjaftueshme për një formim të plotë profesional Burime financiare të mjaftueshme Tutorë dhe pedagogë të përshtatshëm dhe ekspertë Strukturë organizative e përshtatshme, me kapacitetet e nevojshme profesionale Programim i aktiviteteve orientuese, analizuese sipas kërkesave të tregut dhe përcaktimi i një programi formues Seleksionimi dhe vlerësimi i studentëve Efikasiteti dhe efienca në aktivitetet e ndryshme të parashikuara. <p>Kriteri 4 Institucioni disponon dokumentacion që provon përbërjen e rrjetit formues dhe të gjitha strukturave të përfshira në formimin specializues (qendrore/bazë, dytësore, etj) dhe konvencionet eventuale me këto struktura dhe me ato komplementare.</p> <p>Kriteri 5 Strukturat qendrore dhe dytësore të përfshira në formimin specializues duhet të jenë të akredituara nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron ekzistencën e shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve. Shërbimet e përgjithshme dhe diagnostikuese të pranishme në strukturat shëndetësore pjesë e rrjetit formues nuk mund të jenë të ndryshme apo inferiore nga ato të parashikuara në</p>	<p>Institucioni plotëson kërkesat minimale të përgjithshme të parashikuara në këtë dokument përsa i përket rrjetit formues. Programi realizohet në godinën qendrore të Fakultetit të Shkencave Mjekësore duke shfrytëzuar hapësirat e sallave klinike, seminareve, etj. Gjithashtu në dispozicion të programit është edhe Klinika Stomatologjike Universitare “Çerçiz Mingomataj” e cila funksionon në bazë së rregullore së saj.</p> <p>Institucioni plotëson kërkesat minimale specifike për çdo specialitet të parashikuara në shtojcën 2 të këtij dokumenti përsa i përket rrjetit formues.</p> <ol style="list-style-type: none"> Programi realizohet në mbjentet e Fakultetit të shkencave Mjekësore, në salta klinike të pajisura me poltrona dentare dhe me të gjitha mjetet e nevojshme për të punuar me pacientët. Sallat e seminareve janë të përshtatshme, me ndriçim, kondicioner, videoprojektorë, kompjutera, karrige dhe tavolina, të gjitha në funksion të ealizimit të një mësimdhënie sa më cilësore. Brenda godinës ka hapsira për Day Surgery, me shtretër, salla ambulate, ekzaminimi radiologjik, laborator për përgatitjen e aparateve, sallat për ndërhyrje në specilaitet e tjera. në dispozicion të programit është edhe Klinika Stomatologjike Universitare “Çerçiz Mingomataj”. Është parashikuar një numër i mjaftueshëm procedurash klinike për një formim të plotë profesional. Politikat e insitucionit duke ofruar shërbime me çmime shumë më të ulëta krahasuar me klinikat private nga njëra anë dhe nevoja në rritje për trajtim ortodontik nga ana tjetër, kanë bërë që pranë programit dhe Klinikës Universitare të ofrohet një numër i madh pacientësh. Studentët e programit, nën mbikqyrjen e tutorëve ndjekin pacientët e tyre, asistojnë në punën në grup si edhe bëhen pjesë e diskutimeve të hapura nga Udhëheqësi i specializimit për çdo rast klinik. Burimet financiare janë të ardhura jo vetëm nga tarifat e studentëve por edhe shërbimit ndaj të tretëve. Personeli akademik i përfshirë këtu pedagogët dhe tutorët, janë me eksperiencë pune mbi 10 vjeçare dhe me diploma në specialitetin përkatës ose që përfshihet në program. Ndër tutorët ka edhe mjekë italianë të cilët sikundër e theksuam më sipër kanë eksperiencë pune
--	--

² Me rrjet formues nënkuptohet bashkësia e të gjitha strukturave të përfshira në aktivitetet e parashikuara për secilin program specializues: strukturat qendrore/bazë, dytësore dhe komplementare.

shtojcën 2 për akreditimin e strukturave.

Kriteri 7 Institucioni disponon dokumentacion që sqaron ekzistencën e specialiteteve të ngjashme në strukturat shëndetësore pjesë të rrjetit formues, shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specialistëve (sipas shtojcës 2).

Kriteri 8 Institucioni disponon dokumentacion që sqaron numrin e shërbimeve mjekësore që ofron për ushtrimin profesional të specialistëve (sipas shtojcës 2).

Kriteri 9 Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron aktivitetin asistencial kompleks vjetor të strukturave të përfshira në rrjetin formues. Aktiviteti asistencial vjetor që kryhet nga specialistët në kuadër të formimit të tyre nuk mund të jetë më i madh se 30% e aktivitetit asistencial total që kryejnë strukturat e përfshira në rrjetin formues (sipas shtojcës 2).

mbi 10 vjeçare dhe i përkasin kategorisë PAK. Në total janë 12 tutorë dhe çdo tutor ka në mbikqyrje 2-3 studentë.

- e. Strukturë organizative është e përshtatshme dhe ka kapacitetet e nevojshme profesionale. Programi i Studimit Specializim Afatgjatë në Ortognatodonci zhvillohet në ambjentet e Fakultetit të Shkencave Mjekësore pranë Albanian University. Institucioni ofron ambiente të përshtatshme për zhvillimin e planit mësimor si salla leksionesh, salla klinike, laboratore, bibliotekën, etj. Departamenti i Stomatologjisë si njësi bazë që e propozon këtë program, ka personel akademik me kohë të plotë dhe me kontratë të cilët plotësojnë një pjesë të konsiderueshme të nevojave të programit për mësimdhënie. Personeli administrativ i institucionit është në ndihmë të mbarëvajtjes së Programit të Studimit Afatgjatë në Ortognatodonci gjithashtu
- f. Programim ofrohet pas një studimi të tregut të punës, informacioneve të marranga urdhërat e profesionistëve si edhe nga të dhënat e pacientëve të paraqitur pranë Klinikës Universitare dhe me nevojë për trajtim ortodontik.
- g. Për të hyrë në këtë program studimi studentët seleksionohen sipas një procedure konkurruese. Renditja e fituesve nis nga pikët më të larta dhe regjistrohen deri në numrin e parashikuar sipas kërkesës nga njësi bazë. Kërkesa nga njësi bazë është në varësi të kapaciteteve infrastrukurale dhe akademike që njësi ofron. Për këtë program u parashikua një numër deri në 30 studentë. Vlerësimi në vazhdimësi i studentëve realizohet nga provimet e lëndëve përkatëse, kurse përsa i përket pjesës klinike, plotësimi i librezës së studentit konsiderohet një dokumen shumë i rëndësishëm që pasqyron punën e kryer nga ai me pacientët. Institucioni ruan të arkivuara të gjithë dokumentacionet që vërtetojnë ndërlidhjen me strukturat e tjera të specializuara të tipit Qendra Spitalore Universitare apo dhe struktura Private të cilat kanë ndihmuar në formimin e përgjithshëm të specialistëve.

Programi i studimit në "Ortognatodonci", ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore në Albanian University, institucioni i akredituar me Vendim BA Nr. 90, datë 20.10.2017 si pranë një programi universitar të akredituar siç është programi i integruar i studimeve "Master i Shkencave" në Stomatologji Akredituar me Vendim Nr. 88 datë 2017-09-21 dhe Klinika Universitare Stomatologjike e Licencuar me numrin serial: LN-4768-03-2018 proces akreditimi nga QKCSAISH.

Pranë këtij institucioni ofrohen shërbime për të gjitha specialitetet e tjera në fushën e Stomatologjisë, laboratorë, salla klinike, qendër të diagnostikimit radiologjik, etj të cilat përfshihen edhe në formimin e specialistëve.

Të gjitha shërbimet mjekësore që ofrohen për ushtrimin profesional të specialistëve dokumentohen në kartelat klinike dhe librezën e studentit. Në Klinikën Universitare bëhet një planifikim dhe shpërndarje e rasteve klinike që kanë nevojë për trajtim ortodontik. Të

	<p>gjitha shërbimet e ofruara nga specialistët kryhëen nën mbikqyrjen e tutorëve.</p> <p>Institucioni disponon dokumentacion që sqaron aktivitetin asistencial kompleksiv vjetor të strukturave të përfshira në rrjetin formues.</p>
--	--

Standardi III. 4- Institucioni është i mirëorganizuar dhe disponon burime njerëzore të mjaftueshme për mirëfunksionimin e programeve specializuere.

Kriteri 1 Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm që provon dhe përshkruan strukturën organizative dhe figurat drejtuese, akademike dhe profesionale të angazhuara.

Kriteri 2 Çdo program specializues përcakton:

a. Një figurë drejtuese, përgjegjësi i programit të specializimit. Përgjegjësi i programit të specializimit të ketë të paktën titullin “Profesor i asociuar” dhe 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit.

b. Këshilli i profesorëve përveç përgjegjësit të programit të specializimit, përcakton një këshill drejtues të programit të studimit i cili, në bashkëpunim me përgjegjësin e programit të specializimit, punon për përgatitjen, organizimin dhe kontrollin e programit të specializimit në fjalë.

c. Një përgjegjës për menaxhimin ekonomik-financiar dhe përmbushjen e kërkesave administrative.

d. Të paktën një përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm.

Në zyrën e Burimeve Njerëzore pranë Albanian University, ndodhet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm mbi strukturën organizative dhe figurat drejtuese, akademike dhe profesionale të angazhuara në këtë program studimi.

Përgjegjësi i programit të specializimit afatgjatë në “Ortognatodonci” pranë Albanian University është Prof. Anesti Kondili, Akademik dhe më një përvojë mbi 10 vjet në ushtrimin e profesionit.

Këshilli drejtues i këtij programi studimi, përveç Përgjegjësit të programit ka edhe 4 anëtarë të tjerë, nga të cilët 3 Profesorë dhe një më Doktoraturë të mbrojtur në Universitetet Europiane. Bazuar edhe në rregulloren e specializimit ata punojë për përgatitjen, organizimin dhe kontrollin e programit të specializimit.

Zyra e financave e universitetit përgjigjet për menaxhimin ekonomik-financiar dhe përmbushjen e kërkesave administrative.

Monitorimi dhe vlerësimi i brendshëm realizohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Mjetet e përdorura janë pyetësorët online, focus grupet, etj. Grupet e sigurimit të cilësisë janë ngritur edhe në nivel departamenti.

Standardi IV. 1 - Personeli i angazhuar në programet specializuere plotëson standardet e parashikuara

Kriteri 1 Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm që përshkruan strukturën didaktike dhe figurat profesionale të angazhuara në programin specializues.

Kriteri 2 Institucioni disponon personel akademik, pedagogë dhe tutorë, sipas specifikimeve në shtojcën 2.

a. Pedagogë universitarë: profesorë, profesorë të asociuar dhe docentë, për jo më pak se 50% të pedagogëve të përfshirë në programin specializues. Të paktën një profesor i brendshëm është nga sektori disiplinor i programit të specializimit që ofrohet nga institucioni.

b. Pedagogë jo universitarë që ushtrjnë profesionin në strukturat e rrjetit formues: personel me eksperiencë didaktike-formuese të dokumentuar dhe me eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare pranë strukturave të përfshira në rrjetin formues, për një maksimum prej 50% të pedagogëve dhe me të cilët është lidhur një kontratë me kohëzgjatje të paktën sa kohëzgjatja e secilit program specializues.

c. Pedagogë të jashtëm me kontratë: ekspertë të sektorëve të ndryshëm disiplinorë, për një numër maksimal prej 10% të numrit total të pedagogëve, të cilët mund të angazhohen vetëm në mungesë të profesorëve universitarë.

Kriteri 3 Numri dhe niveli i kërkuesve të angazhuar

Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm që përshkruan strukturën didaktike dhe figurat profesionale të angazhuara në programin specializues. Ky dokumentacion përditësohet në fillim të çdo viti akademik. Personeli akademik vlerësohet si më poshtë:

a. Stafit me tituj “Profesor”, “Profesor i Asociuar” dhe PhD të mbrojtura në Universitetet Evropiane zëne mbi 50% të numrit të pedagogëve të përfshirë në këtë program (23 pedagogë me tituj/grada/SPA përkundrejt 29 pedagogë gjithsej).

b. Të gjithë tutorët e përfshirë në program kanë një eksperiencë pune mbi 10 vjet. 50% e tyre i përkasin personelit akademik efektiv (4 PAE / 4 PAK).

c. Në Programin e Studimit Specializim Afatgjatë në Ortognatodonci si PAK janë 7 pedagogë ndër të cilët 4 me titullin Profesor, 2 Profesor i Asociuar dhe 1 Doktor i Shkencave Mjekësore. Të gjithë i përkasin fushës së specializimit ose janë ekspertë në lëndët e përfshira në kurrikulën e këtij programi.

Raporti PAE/PAK është 63% / 37%.

Përsa i përket personelit akademik me kohë të plotë dhe me tituj akademikë “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose gradë shkencore “Doktor” apo “PHD” të fituar në universitete të mirënjohura në botë,

<p>në këto programe përbën një garanci për realizimin e programeve (50% e tyre duhet të jenë personel akademik i brendshëm, të angazhuar në punën klinike dhe me tituj akademikë: “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose gradë shkencore “Doktor” apo “PHD” të fituar në universitete të mirënjohura në botë dhe të shquar për cilësi dhe veprimtari të pasur klinike/kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse.</p>	<p>këta përbëjnë 81 % të stafit akademik të brendshëm , pra mbi 50% të PAE në total.</p> <p>Çdo tutor në këtë program studimi mbikqyr 2 ose 3 studentë.</p>
<p>Kriteri 4 Numri i studentëve që mund të ndiqet nga një tutor është jo më i madh se 3 (tre).</p>	

Standardi IV. 2 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit konform statutit dhe rregullores së përcaktuar nga vetë institucioni.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Faakultetit të Shkencave Mjekësore, njësia bazë parashikon nevojën për rekrutimin e personelit akademik, ia përcjell Dekanatit, ky i fundit ia përcjell Rektorit dhe Rektori përcakton kriteret e pranimit. Vendet vakante shpallen në faqen zyrtare të institucionit dhe më pas vazhdohet me procedurat e rekrutimit.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit dhe detyrave që u janë caktuar.</p>	<p>Albanian University ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Kjo realizohet nga NJSBC. (me tej në kapitullin 6)</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Të gjitha të dhënat që lidhen me procesin e rekrutimit ruhen pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore. Në këtë zyrë u vëzhguan dosjet e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kontratë, për të konfirmuar nëpërmjet CV-së ekperiencën klinike, specializimet përkatëse si edhe kontratat e punës. Në secilën dosje ishin prezent fotokopja e kartës së identitetit, CV, diploma e shkollës së lartë së bashku me listën e notave, diplomat për gradën/ titullin akademik, çertifikatat e specializimit, dëshmia e mbrojtjes së gjuhës/gjuhëve të huaja, kontrata e punës si edhe aneksi në të cilin parashikohej ngarkesa mësimore për vitin akademik.</p> <p>Dosjet u kontrolluan në mënyrë rastësore dhe të gjitha kishin dokumentat e sipërpërmendura.</p>

Standardi IV. 3- Institucioni mund të ofrojë programe mësimdhënieje në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.

<p>Kriteri 1 Institucioni, që ofron programe mësimdhënieje në gjuhë të huaj, plotëson të njëjtat standarde të përcaktuara për IAL-të që ofrojnë programet e studimeve specializuese të fushës së mjekësisë në gjuhën shqipe.</p>	<p>Albanian University ofri programin e studimit afatgjatë në Ortognatodonci” në gjuhën shqipe. Përfshirja e pedagogëve të huaj në program nuk ka sjellë probleme për studentët jo vetëm për faktin se shumica e tyre janë njohës të mirë të gjuhëve të huaja (italisht, anglisht), por edhe sepse janë marrë masa që në sallat klinike të jetë gjithmonë prezent një person nga stafi i institucionit i cili ka bërë përkthimin.</p>
<p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënieje në gjuhë të huaj ka kryer së paku pesë vjet studime në një institucion të huaj në të njëjtën gjuhë mësimdhënieje, ose disponon një certifikatë për njohje të avancuar të gjuhës së mësimdhënieje të njohur ndërkombëtarisht në nivelin C1, dhe ka kryer së paku një vit studime në një institucion me të njëjtën gjuhë mësimdhënieje,.</p>	
<p>Kriteri 3 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënieje në gjuhë të huaj ka mbajtur mbi 10 kumtesa shkencore në këtë gjuhë.</p>	

Standardi IV. 4- Specializanti ka një tutor që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit.

<p>Kriteri 1 Studenti ka një udhëheqës klinik (tutor) të diplomuar dhe specializuar në fushën e programit të studimit të aplikantit i cili ka një eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën klinike në fjalë dhe ka</p>	<p>Studentët ndahen në grupe prej 2-3 studentësh dhe secili grup ka një udhëheqës klinik (tutor) të diplomuar dhe specializuar në fushën e programit të studimit të aplikantit i cili ka një eksperiencë të paktën 10</p>
--	---

<p>gradën “Doktor”.</p> <p>Kriteri 2 Studentit që ka një udhëheqës klinik që nuk është pjesë e personelit akademik të institucionit që ofron programin e specializimit, i caktohet dhe një udhëheqës akademik, anëtar i personelit akademik të institucionit me së paku gradën shkencore “Doktor” apo “PhD” (të fituar në universitete, të mirënjohura në botë) në fushën në të cilën vazhdon studimet specializanti.</p> <p>Kriteri 3 Këshilli i Profesorëve përzgjedh udhëheqësit klinikë, të aftë për të drejtuar punën klinike e kërkimore të specializantëve, mbështetur në vlerësimin e veprimtarive klinike e kërkimore botuese të tyre, brenda e jashtë vendit.</p> <p>Kriteri 4 Tutori është i punësuar me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rrjetit formues dhe ka një kontratë bashkëpunimi me institucionin që ofron programin specializues.</p> <p>Kriteri 5 Udhëheqësit klinikë punojnë për përditësimin e njohurive dhe aftësive të tyre, mbështetur në marrëveshjet institucionale, me qëllim mundësimin e shkëmbimeve të praktikave më të mira dhe dhënien e këshillave në mbështetjen efektive të studentëve.</p> <p>Kriteri 6 Udhëheqësi klinik i studentit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e përparimit të punës klinike të studentit.</p> <p>Kriteri 7 Udhëheqësi klinik ka ekspertizën, formimin dhe udhëzimet e duhura për rolin e tij në udhëheqjen e specializantit në realizimin e studimeve specializuese dhe në veçanti të pjesës praktike/klinike.</p> <p>Kriteri 8 Udhëheqësi nuk mund të mbikëqyrë më shumë se 3 (tre) studentë njëkohësisht.</p> <p>Kriteri 9 Fusha e specializimit të udhëheqësit përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti.</p> <p>Kriteri 10 Në të gjitha rastet, studentit ka vetëm një pikë të identifikuar kontakti, i cili duhet të jetë udhëheqësi klinik kryesor i tij. Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studentit i bëhet e ditur se cili do të jetë personi që do ta zëvendësojë.</p> <p>Kriteri 11 Institucioni siguron që udhëheqësi të ketë kohën e mjaftueshme për ta mbikëqyrur specializantin.</p>	<p>(dhjetë) vjeçare në fushën klinike në fjalë dhe ka gradën “Doktor”.</p> <p>Udhëheqësi i programit organizon, kontrollon, koordinon punën në grupe dhe kujdeset që tutorët të jenë të pranishëm gjatë ndërhyrjeve terapeutike.</p> <p>Bazuar në rregulloren e specializimit, Këshilli Drejtues përzgjedh udhëheqësit klinikë duke vlerësuar veprimtarinë klinike e kërkimore botuese të tyre, brenda e jashtë vendit. Të gjithë janë me titull specialistë të fushës dhe/ose të doktoruar në fushën e ortognatodonsisë.</p> <p>Tutorët janë të punësuar me kohë të plotë pranë njëres nga strukturat e rrjetit formues ose të punësuar pranë një institucioni me të cilin Albanian University ka një kontratë bashkëpunimi.</p> <p>I gjithë personeli akademik, përfshirë edhe udhëheqësit klinikë stimulohen nga institucioni për të qënë aktivë në kërkimin shkencor dhe punën klinike. Fakti që një pjesë e udhëheqësve klinike janë të huaj krijon mindësinë e përcjelljes së një eksperience të konsoliduar jo vetëm profesionale, por edhe në mësimdhënie.</p> <p>Udhëheqësi klinik është gjithmonë pranë grupit të studentëve të tij. Asnjë procedurë klinike nuk zhvillohet nga studenti pa mbikëqyrjen e udhëheqësit klinik dhe miratimin e udhëheqësit të programit.</p> <p>Të gjithë udhëheqësit klinikë kanë një eksperiencë pune mbi 10 vjet dhe janë specialist të fushës. Udhëheqësi klinik mbikëqyr grupe 2- 3 studentësh njëkohësisht.</p> <p>Fusha e specializimit të udhëheqësve përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti.</p> <p>Në të gjitha rastet, studentit ka vetëm një pikë të identifikuar kontakti, i cili duhet të jetë udhëheqësi klinik kryesor i tij. Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studentit i bëhet e ditur se cili do të jetë personi që do ta zëvendësojë.</p> <p>Institucioni siguron që udhëheqësi të ketë kohën e mjaftueshme për ta mbikëqyrur specializantin.</p> <p>Tutorët janë gjithmonë prezent në menyre që të mbështesin udhëheqësin e programit i cili gjithsesi duhet të firmosë për çdo procedurë të realizuar nga specializantet.</p>
---	---

Standardi IV. 5- Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit.</p>	<p>Informacionet mbi anëtarët e personelit akademik ndodhen pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore. Për secilin anëtar ka një dosje personale me të dhëna si: CV, diploma e shkollës, diploma specializimi, dëshmi të gjuhës së huaj, kontrata e punës.</p>
---	--

Standardi IV. 6- Institucioni angazhohet në kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

 “AU” ka organizuar disa programe kualifikimi dhe zhvillimi profesional për personelin akademik dhe personelin mbështetës. Mund të përmendim këtu organizimin e Konferencës Shkencore Vjetore apo aktivitete të tjera shkencore në mbështetje të kontratave të bashkëpunimit që Albanian University ka me Universitete Europiane. |

	Institucioni disponon një sërë të dhënash të programeve të kualifikimit si në hard copy, ashtu dhe në rrugë elektronike. Stacioni televiziv UTV ndihmon në zhvillimin dhe kujtesën e veprimtarive formuese kualifikuese.
Standardi IV. 7- Institucioni mban një bazë të dhënash në lidhje me veprimatrinë kërkimore shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të përfshirë në këtë veprimtari, në rast se ka, edhe të mbështetjes financiare të institucionit ndaj tyre.</p> <p>Kriteri 2 Baza e të dhënave përmban botime akademike (tekste, monografi, libra, artikuj) apo kumtesa në konferenca brenda a jashtë vendit.</p>	<p>Dosja personale e personelit akademik në Departamentin e Stomatologjisë, përditësohet në vazhdimësi në varësi të aktivitetit shkencor të individit. Ka patur raste që vetë institucioni ka mbështetur financiarisht aktivitetin shkencor të personelit.</p> <p>Baza e të dhënave përmban botime akademike (tekste, monografi, libra, artikuj) apo kumtesa në konferenca brenda a jashtë vendit, kurse kualifikimi, etj.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>GVJ pas vizitës në institucion dhe njohjes me dokumentacionin përkatës konkludon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rrjeti formues pranë Albanian University plotëson kriteret minimale të parashikuara dhe është i përshtshëm për të ofruar specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë. Klinika Stomatologjike mbështet programin e specializimit në “Ortognatodonci” dhe funksionon në bazë së rregullore së saj. - Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm që provon dhe përshkruan strukturën organizative dhe figurat drejtuese, akademike dhe profesionale të angazhuara. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit konform statutit dhe rregullores së përcaktuar nga vetë institucioni. Personeli akademik është me tituj /grada shkencore dhe me eksperiencë profesionale mbi 10 vjet. - Udhëheqësit klinikë mbikqyrin grupe prej 2-3 studentësh dhe janë përgjegjës për mbikqyrjen, kontrollin dhe vijueshmërinë e procedurave klinike me pacientët. Mësimdhënia realizohet në gjuhën shqipe, por merren masa për përkthimin në rastet kur janë pedagogët e huaj. - Departamenti ndjek edukimin në vazhdimësi të aktivitetit shkencor të anëtarëve, kurse pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore janë prezente dosjet me të dhënat personale si edhe kontratat e punës. - Albanian University angazhohet në kualifikimin e vazhdueshëm të personelit të tij, qoftë duke organizuar aktivitete shkencore vetë si institucion, ashtu edhe duke mbështetur financiarisht stafin akademik. 	

4. Infrastruktura dhe logjistika në funksion të programit të SPA


Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Aktiviteti mësimor i programit të specializimit afatgjatë në “Ortognatodonci” i cili ofrohet nga Fakulteti Shkencave Mjekësore, Departamenti i Stomatologjisë i AU zhvillohet në godinën e ish Gjykatës në rrugën e Durrësit dhe në godinën e ish Internacionalit rruga “Kajo Karafil” të cilat ndodhen në një distancë tv shkurtër nga njëra tjetra.

Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi:

- mjediset e programit të SPA për strukturat qendrore si sallat e leksioneve dhe seminareve, sallën e internetit, bibliotekën, sekretarinë, zyrat e departamentit, librarinë, nyjet hidrosanitare, mjediset shlodhëse, kafeteritë etj.



- mjediset e Klinikës Stomatologjike Universitare: salla odontostomatologjike, day surgery, salla e operimit, kabineti i radiologjise, salla e ortodoncisë, salla e kirurgjisë orale.

Infrastruktura e Fakultetit është moderne, klasa me hapësira të mëdha, laboratorë moderne të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike për programet e studimit. Fakulteti ka salla konferencash, të pajisura me kompjuter, video projektor, flipcharte, etj .

Labororet e lëndëve klinike janë të pajisur me aparatura stomatologjike, instrumentar, grafi dixhitale, materiale të ndryshme dentare, aparatura për kontrollin e infeksionit.

Programi i specializimit realizohet kryesisht në Klinikën Stomatologjike Universitare në të cilat kryhet praktika mësimore klinike te parashikuar sipas programit të studimit për çdo lëndë të tij.

Tregues të matshëm:

- Mjediset në funksion të programit SPA (Tabela 7 në aneks)

Në të gjithë aktivitetin e tij mësimor ashtu dhe atij krijues FSHM ka në shfrytëzim një sipërfaqe totale rreth 4102 m².

Gjate vizitës në institucion, GVJ konstatoi të njëjtën gjendje me të dhenat e deklaruar nga Institucioni në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) për këta tregues në tabelën 6 të RVB.

- Dokumentacioni përkatës (planimetritë, të dhëna për teknologjinë e pajisjeve kërkimore) në Aneksin Nr IV.1

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III. 1- Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimit të të gjitha cikleve të studimit dhe në veçanti të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore.</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise duhet të jenë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme infrastrukturore dhe teknologjike. Ai disponon struktura administrative dhe klinike, të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit specializues sipas standardeve specifike bashkëngjitur këtij dokumenti (Shtojca 2).</p> <p>Kriteri 4 Institucioni disponon struktura të akredituara për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme klinike dhe didaktike. Akreditimi i këtyre infrastrukturave kryhet nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore. Objekt i akreditimit janë strukturat përbërëse pjesë të rrjetit formues të njësisë që ofron programet e studimit specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë. Për struktura nënkuptohen strukturat fizike (departamentet, njësitë operative, shërbimet, qendrat, laboratorët, poliambulatorët, etj) pjesë e rrjetit formues ku zhvillohen aktivitetet dhe shërbimet e nevojshme për formimin e specializantëve.</p> <p>Veçanërisht objekt i akreditimit janë strukturat qëndrore të njësisë që ofron programet e studimeve specializuese afatgjata, si ato të fakultetit apo universitetit. Këto struktura si dhe menaxhimi organizativ, administrativ, didaktik dhe teknik shëndetësor dhe aktivitetet e lidhura me to, koordinimi dhe/ose drejtimi i tyre për çdo njësi që ofron programe studimi specializimi, duhet të jenë të përshtatshme dhe strukturat të pajisura mjaftueshëm për organizimin dhe realizimin e aktivitetit formues profesional specializues në fushën e mjekësisë. Edhe në rastet kur mund</p>	<p>Institucioni ka një vendndodhje të përhershme që prej 15 vjetësh.</p> <p>Mjediset ku kryhet veprimtaria mesimore, klinike dhe ajo administrative me klasa, salla klinike, laboratore, zyra , salla leksionesh jane te pajisura me aparatura dhe materiale stomatologjike, pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që janë të përshtatshme për mësimdhënie dhe aktivitetet e parashikuara ne programin e studimit në përputhje me qëllimet e programit.(evidencë IV.1)</p> <p>Në funksion të programit të studimit është dhe Klinika Stomatologjike Universitare, e cila është e e organizuar sipas nje organigrame, (evidence IV.2) dhe funksionon sipas një rregullore të posaçme. (evidencë III.1)</p> <p>Klinika ka strukturë me shtretër për shërbimin Day Surgery si dhe ka dy salla kirurgjie dhe implantologjie, sallë lavazhi për mjekët, sallë ambulatorë, salla ku zhvillohen praktikat e ortognatodoncisë dhe odontostomatologjisë. Sallat janë të pajisura për dhënien e ndihmës së shpejtë. Klinika Stomatologjike</p>

<p>të ekzistojnë më shumë se një strukturë e akredituar si struktura qendrore/bazë, vetëm një prej tyre mund të konsiderohet si strukturë bazë efektive e njësies që ofron programet specializuese afatgjata.</p> <p>Objekt i akreditimit janë edhe strukturat dytësore të konvencionuara me strukturën qendrore/bazë të cilat shërbejnë për të arritur ose kompletuar aktivitetin asistencial të kërkuar për formimin e specialistit, të cilat mund të jenë struktura universitare ose jo universitare, të të njëjtës strukturë spitalore ose jo. Në rastet kur programi i studimit parashikon frekuentimin e strukturave, shërbimeve, aktiviteteve, laboratorëve ose gjithçka tjetër që nuk bën pjesë në strukturën qendrore/bazë ose në strukturat dytësore të lidhura me të, institucioni që ofron programin e studimit lidh një kontratë ose konvencion me këto struktura komplementare. Në këto raste duhet të ketë marrëveshje të veçanta mes IAL-së dhe strukturës në fjalë dhe të respektohen standardet e parashikuara për strukturat qendrore/bazë e dytësore.</p> <p>Kriteri 5 Akreditimi i strukturave të rrejtet formues bëhet pas verifikimit të plotësisht nga ana e IAL-së të standardeve të përshkruara në këtë dokument dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe i jep të drejtën IAL-së që ofron programet specializuese të përdorë këto struktura për të organizuar e realizuar aktivitetin formues specializues për secilin specialitet. Strukturat e akredituara për një specialitet të caktuar mund të shtrijnë aktivitetin formues, me kërkesë të IAL-së, edhe në specialitete të tjera me kusht që të plotësojnë të gjitha standardet dhe kriteret e parashikuara për atë specialitet.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni mund të organizojë programe të përbashkëta të studimeve specializuese afatgjata me një a më shumë institucione të tjera në vend, të njohura/akredituara nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qendrën Kombëtare të Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, ose të huaja të akredituara për zhvillimin e programeve specializuese analoge në vendin përkatës, në bazë marrëveshjesh midis tyre.</p>	<p>Universitare ka Kabinetin e Radiologjisë i cil ka një rëndësi të veçantë në këtë program studimi me ekzaminimet që kryen (panoramex, cefalometri etj) të domosdoshme për diagnostikimin e defekteve skeletike duke mundësuar planifikimin e planit të trajtimit.</p> <p><i>Ky program studimi ofrohet nga Albanian University, Fakulteti i Shkencave Mjekësore akredituar me Vendim BA Nr. 90, datë 20.10.2017, Departamenti i Stomatologjisë, program i akredituar me Vendim Nr. 88, datë 21.09.2017, Klinika Universitare Stomatologjike e Liçensuar me numrin serial: LN-4768-03-2018 proces akreditimi nga QKCSAISH.</i></p> <p>Klinika Universitare , me vendndodhje në godinën e Ish-Gjykatës, është pjesë e rëndësishme e programit të studimit. Në Klinika Universitare kryhen praktikat klinike dhe paraklinike të programit mësimor. Klinika Universitare ka :</p> <ol style="list-style-type: none"> salla të praktikës paraklinike (2 laboratorë me afërsisht 50 vende pune) ku aplikohen punimet dentare në kukulla-model, 6 salla klinike dhe 1 sallë filtri, ku kryhen punimet klinike nga ana e studentëve (me 77 unite dentare)
<p>Standardi III. 2 - Strukturat e përfshira duhet të disponojnë standardet e përgjithshme dhe specifike të parashikuara</p>	
<p>Kriteri 1 Strukturat qendrore dhe dytësore disponojnë standarde të përgjithshme në përputhje me kapacitetin infrastrukturor, teknologjik, organizativ dhe asistencial sipas kriterëve të mëposhtme dhe sipas kriterëve specifike të parashikuara në shtojcën 2:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kapaciteti infrastrukturor: hapësira të mjaftueshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara; Kapaciteti teknologjik: pajisje të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara; Kapaciteti organizativ: kompetenca të nevojshme profesionale; Kapaciteti asistencial: sasi dhe tipologji të caktuar të ndërhyrjeve klinike. <p>Kriteri 2 Të gjitha strukturat (psh. auditorët, biblioteka, sekretaritë, etj.) plotësojnë standardet e përgjithshme.</p> <p>Kriteri 3 Struktura bazë është e pajisur me ambientet/pajisjet e nevojshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> për administratën dhe strukturat ndihmëse (sekretari didaktike, bibliotekë tradicionale dhe telematike, sallë mbledhjesh, dhomë për specializantët) kompjuter në dispozicion të sekretarisë dhe administratës program të kompjuterizuar për menaxhimin e të dhënave të sekretarisë didaktike faqe interneti të tijin linja telefonike dhe pajisje për fotokopje salla për leksionet dhe seminarët laboratorë kërkimorë dhe didaktikë 	<p>Gjate vizitës në Institucion GVJ konstatoi se institucioni disponon kapacitetin infrastrukturor, teknologjik, organizativ për organizimin dhe funksionimin e programit të specializimit në "Ortognadonci" duke bërë të mundur përmbushjen e qëllimit të këtij programi .</p> <p>Specializantët janë të ndare në grupe me nga 3 studentë. Çdo grup mbikqyret nga një tutor i cili së bashku udhëheqësin e programit të specializimit i asiston dhe mbikqyr studentët në praktikat klinike. Sallat klinike janë të pajisura me të gjitha aparaturat, instrumentarin, materialet dentare të domosdoshme për trajtimin e pacientëve. Aparaturat, materialet dentare për trajtimin e pacientëve janë të certifikuara dhe plotësojnë standardet e shërbimeve stomatologjike.</p> <p>U njohëm me faktin se ky program studimi ka ndihmuar në trajtimin e 473 pacientëve me anomali të ndryshme skeletale dhe dentare.</p> <p>Struktura bazë është e pajisur me ambientet, pajisjet e nevojshme për administratën dhe strukturat ndihmëse si sekretarinë, bibliotekë, sallë mbledhjesh, dhomë për specializantët.</p>

<p>h. kompjuter në dispozicion të studentëve të pajisur me lidhje interneti dhe akses në bazat e të dhënave profesionale on line (së paku 1 kompjuter / 5 studentë)</p> <p>i. adresë poste elektronike personale për specializantët të ofruar nga struktura universitare</p> <p>j. ambulatorë dhe struktura asistenciale (me pajisjet e nevojshme teknologjike sipas specialitetit)</p> <p>k. ambiente spitalore me shtretër (në rastet kur janë parashikuar në standardet specifike të specialitetit në shtojcën 2)</p> <p>Ambjentet më sipër sigurojnë standardet e sigurisë dhe ato higjienike dhe nuk kanë barriera arkitektonike që pengojnë aksesin në veprimtaritë e ndryshme të parashikuara nga programi i studimit.</p> <p>Kriteri 4 Çdo program specifik i specializimit plotëson standardet specifike sipas tipologjisë së specializimit (psh. laboratorë specifike, shërbime, shtrime spitalore, etj.) sipas shtojcës 2. Standardet specifike ndahen në:</p> <p>a. bazë: standarde që duhet domosdoshmërisht të përmbushen si nga struktura bazë dhe nga strukturat dytësore/satelite.</p> <p>b. dytësore: standarde që, për të plotësuar kriteret e akreditimit të strukturës, duhet të plotësohen si nga struktura qendrore edhe nga ajo dytësore ose nga strukturat të tjera të IAL-së sipas një përqindjeje të caktuar të parashikuar për akreditimin. Nëse nuk plotësohen as nga struktura bazë e as nga ajo dytësore duhet të plotësohen nga strukturat komplementare me të cilat ka një marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>c. shërbime të përgjithshme: janë shërbimet operative që duhet të ketë struktura në të cilën bën pjesë struktura qendrore ose ajo dytësore që do të akreditohej.</p> <p>Kriteri 5 IAL-të duhet të komunikojnë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të gjitha ndryshimet e kriterëve dhe standardeve që kanë mundur akreditimin jo më vonë se 30 dite nga ndryshimi. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës ekzaminojnë kriteret dhe standardet e ndryshuara dhe japin miratimin e tyre mbi këto ndryshime.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni që ofron programet specializuese ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ kompleksiv në strukturat qendrore dhe dytësore për të mbuluar nevojat e specialiteteve të ofruara, në bazë të kapaciteteve.</p> <p>Kriteri 7 Institucioni që ofron programet specializuese është i mirëorganizuar dhe disponon dokumentacion që tregon mënyrën e organizimit dhe strukturën drejtuese si dhe personelin administrativ dhe akademik me titujt përkatës si dhe rolet e parashikuara për secilin.</p>	<p>Funksionon sekretaria on line e cila menaxhon të dhënat e studentëve. Programi ka faqen e vet në web sitin e universitetit e cila është aktive. https://albaniamuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-mjekesore-2/ si edhe në rrjetet sociale.</p> <p>Gjatë vizitës në bibliotekë konstatuam se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - biblioteka kishte literaturë të pasur profesionale në gjuhë të huaj që pasurohej në mënyrë periodike (revista shkencore, libra të shtëpive botuese Elsevier, Masson, etj) - gjithashtu disponon nje data basë librash on-line në gjuhën angleze. Është krijuar edhe fondi e-book - interneti është në dispozicion të orëve të studimit të studentëve, të pedagogëve. <p>Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve të këtij programi tekste mësimore bazë dhe të rekomanduara. Pedagogu i udhëzon studentët për literaturën bazë dhe ate te rekomanduar e cila është e pasqyruar në syllabusin e çdo lëndë.</p> <p>Institucioni ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ në strukturat qendrore dhe dytësore për të realizuar kete program specializimi. Ky personel ka formimin e duhur dhe është i aftë të mbështesë realizimin e këtij programi.</p> <p>Institucioni është i mirëorganizuar dhe disponon dokumentacion që tregon mënyrën e organizimit dhe strukturën drejtuese si dhe personelin administrativ dhe akademik me titujt përkatës si dhe rolet e parashikuara për secilin i cili gjendet pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ pas vizitës në institucion dhe njohjes me dokumentacionin përkatës konkludon se :

- Institucioni ka një vendndodhje të përhershme që prej 15 vjetësh.
- struktura bazë është e pajisur me ambientet/pajisjet e nevojshme për administratën dhe strukturat ndihmëse si sekretarinë, bibliotekë, sallë mbledhjesh, dhomë për specializantët
- Klinika Universitare ku kryhen praktikat klinike dhe paraklinike të programit të specializimit ka një strukturë të mirëorganizuar dhe funksionon sipas një rregullore të vecantë.
- Institucioni ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ në strukturat qendrore dhe dytësore i cili është i afte për të realizuar këtë program specializimi.
- Biblioteka ka literaturë të pasur profesionale në gjuhë të huaj që pasurohej në mënyrë periodike (revista shkencore, libra të shtëpive botuese Elsevier, Masson, etj)

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Albanian University është një institucion privat i arsimit të lartë dhe ai financohet nga burimet e tij të brendshme të financimit. Burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe aktivitete të tjera tregtare (Klinika, kafe, bare, etj). Qëllimi kryesor i përdorimit të fondeve në këto vite ka qenë investimi në infrastrukturë, pajisje, aparatura, tituj librash, botime, burime njerezore, mirembajtje, qera objektsh etj. Pjesë tjetër e burimeve të të ardhurave shpenzohet për pagesën dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, shërbimin internet, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit.

Ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare në rang universiteti. Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm. Në raport ka të dhëna të hollësishme për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative, etj. Bazuar mbi kriteret e standardeve shtetërore të cilësisë ky Institucion ia ka dalë me sukses që të mbulojë me kosto financiare të gjitha shërbimet e kërkuara.

Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKR.

Tregues të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në vitet e fundit (Tabela 8 në aneks)

Shpenzimet për studentët dhe kosto për mobilitetin e tyre

Shpenzimet për specialistët dhe kosto e studimit për SPA, student për vit akademik është 434000 lekë.

Transparenca dhe kontrolli i brendshëm financiar, Auditimi dhe rezultatet.

Kontrolli i brendshëm bëhet nga një ekspert kontabël, i cili harton Raportin e ekspertit kontabël dhe realizon auditimin e shoqërisë.

Kapacitetet menaxhuese financiare

Institucioni ka një stabilitet financiar dhe kapacitete të mjaftueshme për përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës dhe gjenerimin e të ardhurave në shërbim të programit të studimit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II. 3- Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të gjendjes financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjitha detyrimet financiare, pagat dhe mbështetjet financiare të programit.	AU çdo vit bën një auditim (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës së tij financiare.
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja dhe kontratave të shërbimeve në lidhje me programin e studimit.	Në këtë raport paraqiten në mënyrë të hollësishme të gjitha të ardhurat e realizuara nga financimi i brendshëm (tarifat e studimit, aktivitete tregtare) si dhe detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, etj.
	Nëpërmjet këtij raporti analizohet efienca e përdorimit të

	të ardhurave në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve.
STANDARDI VIII - INSTITUCIONI DISPONON DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE	
Standardi VIII. 1- Institucioni harton një raport financiar të kostos së programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të kostove të përfshira në realizimin e programit të studimit, si kostot operacionale, kostot fikse të ambienteve dhe të pajisjeve, kostot e personelit, etj.</p> <p>Kriteri 2 Raporti financiar përmban të ardhurat e programit për vitet e kaluara akademike.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së programit të studimit dhe dëshmon se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p> <p>Kriteri 4 Programi i studimeve specializuese mbështetet nga një buxhet i mjaftueshëm për të arritur objektivat e programit për çdo student.</p>	<p>Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen</p> <p>Programi i studimeve specializuese mbështetet nga një buxhet i mjaftueshëm për të arritur objektivat e programit për çdo student.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
GVJ konkludon se:	
<ul style="list-style-type: none"> - AU çdo vit bën një auditim (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës së tij financiare - dokumentacioni i lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet është i rregullt dhe dëshmohet edhe nga rezultatet e kontrolleve periodike, të cilave u është nënshtruar Institucioni. - financimi dhe të ardhurat janë pjesë e informacionit dhe të dhënave të Albanian University. - të ardhurat në rritje vitet e fundit tregojnë për një stabilitet financiar - Institucioni vë sasi fondesh për kërkim shkencor, kualifikime, pjesëmarrje të stafit akademik në aktivitete shkencore në varesi të kërkesave të bëra prej tyre. 	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë



Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Në Albanian University, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon që nga viti 2009 -2010. Universiteti për të institucionalizuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, me Vendim Senati Akademik, nr. 178 dt. 23/07/2010, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, dhe së fundmi në përputhje me ligjin për Arsimin e Lartë Nr.80 date 22.07.15 me Vendim Nr. 4 të Senatit Akademik dt. 22/12/2016 ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional, i cila harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë, shprehur edhe në Statutin e AU (Evidencë II.5).

Kjo strukture ka si qëllim vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së procesit mesimor, kerkimit shkencor, stafit akademik, administrativ dhe ndihmës, studentëve, mësimeshënies, shërbimeve të logjistikës dhe shërbimeve të tjera që Universiteti ofron.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka akses në të gjitha informacionet e Universitetit. Kjo njësi është në varësi të drejtpërdrejtë të Rektorit të Universitetit, dhe ka për detyrë paraqitjen e një raporti vjetor

në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies të kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë në të ardhmen.

Detyrat dhe funksionet e NJSBC, janë të parashikuara në nenin 14 të Rregullores së brendshme të Universitetit (Evidencë II.2, neni 14) si dhe në Rregulloret specifike për sistemin e Sigurimit të Cilësisë.

NJSBC funksionon edhe në nivel njësie bazë që në shtator të vitit 2016 me ngritjen e grupeve të Sigurimit të Cilësisë brenda saj, me Vendim Senati Akademik Nr. 157/3 dt. 08/09/2016 (Evidenca VI.1)

Në nivel njësie bazë, në fillim të çdo viti akademik, gjatë procesit të mësimdhënies, dhe në përfundim të tij analizohen dhe vlerësohen programet mësimore, literatura dhe format e vlerësimit. Kontrolli dhe vlerësimi bëhen në bazë të të dhënave statistikore, të mbledhura gjatë anketimeve të studentëve, fokus – grupeve, raporteve të vetëvlerësimit të pedagogëve, raporteve semestrale dhe vjetore të njësisë bazë, si dhe rezultateve të arritura nga studentët. NJSBC në bashkëpunim me njësitë bazë analizon të dhënat dhe nxjerr në pah problemet dhe rekomandimet përkatëse me qëllim përmirësimin e tyre .

Tregues të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC si:

Ne vizitën në institucion, GVJ u takua me anëtarët e NJSBC. GVJ u njoh nga NJSBC me metodologjinë e ndjekur nga njësia për vlerësimin e punës në institucion. Kontrolli i brendshëm i cilësisë së programeve të studimit realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik dhe veçanërisht në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik perara sezonit të provimeve. . Ky vlerësim realizohet me përdorimin e metodologjive të ndryshme, si pyetësorë me studentët, fokus-grupe, raporte vetëvlerësimi të pedagogëve, takime periodike, dite të hapura etj. Të gjitha të dhënat e mbledhura pasqyrohen në raportet semestrale dhe vjetore të njësisë bazë dhe jepen rekomandime për përmirësime të mundshme në të ardhmen. Të gjitha të dhënat e mbledhura pasqyrohen në raportet semestrale dhe vjetore të njësisë bazë dhe jepen rekomandime dhe detyra për përmirësime në të ardhmen.

o Sa anketime kanë bërë me studentët, pedagogët, udhëheqësit e tezës

Bëhen dy anketime në vit, në përfundim të cdo semestri përpara fillimit të sezonit të provimeve realizohen pyetësorët me studentët.

o Sa studentë janë anketuar?

60 % - është numri i studentëve pjesëmarrës në anketën semestrale.

o Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë?

Të gjithë të dhënat e mbledhura nga pyetësorët janë përpunuar .

Studentet e këtij programi janë shprehur të kenaqur me punën e stafit akademik në procesin mësimor. Realizimi i praktikave klinike duke punuar në grupe të udhëhequr nga tutorët ka kenaqur pritshmeritë e studentëve.

Eshtë vlerësuar prej tyre profesionalizmi dhe perkushtimi i udhëheqësit të programit të specializimit Prof.Giovanni Manes Gravina .

o Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm?

Rezultatet e pyetësorit janë diskutuar në nivel njësie bazë duke ruajtur konfidencialitetin dhe janë përcjellur në njësitë kryesore, në NJSBC dhe Rektorat.

Te gjitha ceshtjet e adresuara jane diskutuar duke nxjerre detyra dhe rekomandime per permiresimin e tyre ne vazhdim.

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë për programin e SPA

Kontrolli i brendshëm i cilësisë realizohet nga NJSBC në bashkëpunim me grupet e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti, si dhe nga Komisioni për Vlerësim Institucional. NJSBC për ruajtjen, nxitjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë bashkëpunon me njësitë bazë nëpërmjet Grupeve të Sigurimit të Cilësisë të ngritura në nivel departamenti.

- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Në përfundim të semestrit të parë dhe të dytë njësia baze harton një raport semestral dhe një raport vjetor, në të cilin përfshihen të dhëna mbi çështje që lidhen me programin e studimit, stafin akademik, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, veprimtaria kërkimore shkencore marrëveshjet e bashkëpunimit si dhe masat ,detyrat që lihen për përmirësime në të ardhmen.

- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Në përfundim të çdo viti akademik NJSBC harton raportin vjetor dhe bashkëngjitur këtij raporti dërgon me shkresë pranë Rektoratit sugjerime, rekomandime për përmirësimin e treguesve të cilësisë për vitin e ardhshëm akademik.

- Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme

Referuar vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit institucional me QAA, NJSBC ka marrë vlerësime pozitive, duke e cilësuar si praktikë të mirë ngritjen e grupeve të sigurimit të cilësisë në nivel departamenti me qëllim monitorimin më të detajuar të treguesve të cilësisë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 9- Institucioni përdor instrumente matës, vlerësues, metodologji vlerësimi.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor instrumente matës, vlerësues, metodologji vlerësimi dhe e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin në kohë të pedagogëve, tutorëve dhe strukturave të përfshira në rrjetin formues.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni informon mbi rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet e pritshme.</p>	<p>Albanian University ka Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila monitoron në menyrë të vazhdueshme sigurimin e cilësisë duke përdorur metodologji vlerësimi, instrumenta matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programit të studimit .</p> <p>Këto të dhëna i përfshin në vetëvlerësimin institucional.</p> <p>2 herë në vit në përfundim të semestrit, përpara të sesionit të provimeve realizohen pyetësorët online me studentët ku ata shprehen në kushte anonimiteti për mesimdhënien, kurikulen, vlerësimin dhe transparencën në vlerësim , performancën e Institucionit të dhënave të cilave i bëhen të ditur personelit akademik nëpërmjet Njësisë Bazë.</p>
Standardi IX. 1- Institucioni disponon një strukturë dhe mekanizmat e posaçme të përmirësimit të cilësisë dhe performancës së saj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka dhe përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedurë të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ka mekanizma formale për shqyrtimin,</p>	<p>Institucioni përdor instrumentet e duhur si pyetësorë dhe fokus grupe me studentët dhe ndjek procedurë të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tij.</p> <p>Të gjithë veprimtarinë e saj NJSBC e realizon në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me</p>

<p>miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit, të cilat vlerësohen për pajtueshmërinë e programeve të reja të studimit me strategjinë e institucionit apo fakultetit, metodën e hartimit të programeve dhe zhvillimit të kompetencave të përshkruara në aktet ligjore apo standardet shtetërore të cilësisë.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhohet për zhvillimin e një kulture që njih rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në punën e tyre.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë formale dhe në dispozicion të publikut.</p> <p>Kriteri 6 Studentët dhe aktorë të tjerë nga sektori punëdhënës janë të përfshirë në procesin dhe instrumentet e sigurimit të cilësisë.</p>	<p>Manualin “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit”.</p> <p>Ne institucion kontolli i cilesise eshte shtrire deri ne nivelin e Njesise baze me ngritjen e grupeve ad-hoc.</p> <p>NJSBC për vlerësimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë, bashkëpunon me Komisionin për Vlerësim Institucional në të cilin ben pjesë edhe një përfaqësues i studentëve, si dhe me grupet e sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>GVJ pas vizitës në institucion ,njohjes me dokumentacionin përkatës konkludon se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - institucioni është i angazhuar në sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. - Institucioni në stategjinë e zhvillimit të tij, i ka kushtuar një rëndësi të veçantë sigurimit të cilësisë. - të dhënat e siguruar nga NJSBC për problematika të caktuara që lidhen me programin e studimit analizohen me seriozitet nga institucioni duke marrë masa për zgjidhjen e tyre. - të dhënat e siguruar nga NJSBC me anë të metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta i shërbejnë institucionit për të hartuar dhe zbatuar strategji të reja për përmirësimin e cilësisë 	

PROGRAMI I STUDIMEVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Misioni i programit të studimit Specializim Afatgjatë në “Ortognatodonci”, është përgatitja e specialistëve në këtë fushë të Dentistisë. Objektivat e studimit janë të qarta, ata parashikojnë marrjen e njohurive bashkëkohore në lidhje me animalitë ortodontike dhe mënyrat e trajtimit të tyre, përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor dhe shfrytëzimin eliteraturës bashkëkohore duke e ballafaquar atë me ekperiencën klinike të fituar prej tyre ditë pas dite.

Organizimi i këtij programi mbështetet në Ligjin nr.80/2015, “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në përputje me Nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, shtojca 1, Niveli 8, në përfundim të studimeve specializanti do të pajiset me “Diplomë Specializimi” në “Ortognatodonci”.

Viti mësimor është organizuar në dy semester. Plan mësimor është organizuar me Kurse të integruara, ECTS-të përkatëse, orët javore për secalin prej tyre, të shpërndara në leksione dhe praktika mësimore, në orët në auditor dhe punë të pavarur.

Syllabuset e lëndëve pqsqyrojnë programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit të studentit si edhe literaturën e nevojshme.

Tregues të matshëm:

- Elementë të përgjithshëm të Programit të Studimit (Tabela 9):
- Kohëzgjatja; (të paktën 2-4 vite) Kohëzgjatja e programit të studimit Specializim Afatgjatë në “Ortognatodonci” pranë Albanian University është 3 vjet.
 - Programi i SPA përfshin të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese, dhe 20% për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite sipas një programi të paracaktuar në fillim të programit të studimit. Bazuar në planin mësimor të Programit Specializim Afatgjatë në Ortognatodonci, specializanti fiton në fund të programit 180 ECTS, nga të cilat 27 kredite janë teori (15%) dhe pjesa tjetër prej 153 kreditesh (85%) janë praktika. Nëse marrim në konsideratë orët në auditor, orët teorike janë 202.5 orë (5.8%) dhe orët praktike janë 3265 orë (94.2%). Në planin mësimor i është dhënë një peshë e konsiderueshme pjesës praktike, mbi 80%, ashtu sikundër edhe standartet e parashikojnë (Tabela 9)

Në programin e SPA në “Ortognatodonci” pranë Albanian University, ndarja e krediteve për formimin e përgjithshëm dhe për atë specifik janë parashikuar sipas shtojcës 1 të standarteve shtetërore. Lëndët specifike zënë 60.5% (109 ECTS), nga këto 13,7 % janë lëndë me zgjedhje. Lëndët karakterizuese të fushës zënë 29.4% (53 ECTS) nga të cilat 18% e tyre janë lëndë me zgjedhje. Për lëndët e formimit bazë, lëndët ndërdisiplinore ose integruese dhe për për aktivitete të tjera jzënë 5%. Gjithashtu 5% e krediteve janë parashikuar për provimin final/ temën eksperimentale të diplomës.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- 25 orë pune e studentit barazohet me 1 ECTS; 1 orë mësimore zgjat 50 minuta.
- Provimi (në çdo fund viti akademik). Mënyra e organizimit të provimit dhe vlerësimit të studentit parashikohet në syllabuset përkatëse të lëndëve.
- Provimi përfundimtar/final në përfundim të programit specializues i cili konsiston në testimin praktik dhe atë me gojë të studentit me kohëzgjatje prej të paktën 30 minutash si dhe paraqitjen e temës eksperimentale të diplomës.

Në programin SPA në “Ortognatodonci” provimi final në përfundim të studimeve është parashikuar në këtë mënyrë: Udhëheqesi i Programit vlerëson performancën klinike të studentit duke u bazuar në aktivitetin klinik që studenti ka pasqyruar në librezën e studentit. Në këtë vlerësim hyn edhe sjellja e studentit ndaj pacientit, stafit si edhe kolegëve, impenjimi i tij në punën e drejtperdrejtë mbi pacientin, por edhe ndjekja dhe asistimi në rastet klinike të trajtuara nga studentët e tjerë në grup, Përveç kësaj, çdo student përçatit tezën e diplomës ku pasqyrohet eksperiencia e fituar përgjatë 3 viteve të specializimit dhe ku duhet të prezantohet të paktën një rast klinik i nisur dhe përfunduar nga vetë studenti.

Syllabus-et e lëndëve, kanë të pasqyruar këto elementë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Syllabuset janë hartuar dhe miratuar në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 për “Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

Analizë për cilësinë e syllabuseve

Syllabuset pasqyrojnë temat e leksioneve, praktikave klinike apo laboratoreve të cilat janë në përputhje me specifikat e lëndëve përkatëse. Për të gjitha lëndët në syllabus pasqyrohet mënyra e vlerësimit të studentit duke marrë në konsideratë jo vetëm vlerësimin në provimin final, por edhe performancën vjetore.

Të dhëna për strukturat dytësore brënda ose jashtë vendit, ku studentët kanë kryer aktivitetet asistenciale (ose kërkimet e tyre shkencore):

- Universitet/Qëndër kërkimi dhe zhvillimi të Universitetit Institut/
- Fondacion/Subjekt publik/subjekt privat
- Strukturë spitalore, e tjerë

Albanian University ka marrëveshje bashkëpunimi me disa Universitete jashtë vendit. Në marrëveshjet e bashkëpunimit është parashikuar shkëmbimi i stafit, studentëve si edhe kryerja e moduleve të caktuara pranë këtyre institucioneve. Mund të përmendim disa marrëveshje bashkëpunimi si me : Universitetin e Aquilas (Itali), Universitetin e Napolit (Itali), Universitetin e Pizës (Itali), Universitetin Aristotle (Selanik, Greqi), Universitetin i Mjekësisë dhe Farmacisë (Iasi, Rumani), etj.

Të dhëna për: Botimet/referimet e studentëve; Revistat, entet botuese ku janë botuar këto artikuj

Institucioni ofron për studentët mundësinë e paraqitjes së punimeve të tyre shkencore apo eksperimentale në aktivitetet shkencore që vetë institucioni organizon, si edhe botime në revistën “Optime” të Albanian University. Vlen të përmendet Konferenca Vjetore që organizohet çdo vit nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore dhe ku Departamenti i Stomatologjisë ka hapësirën për të pasqyruar punime shkencore të stafit , por edhe të studentëve në bashkëpunim me pedagogët apo tutorët e tyre.

Të dhëna për provimin përfundimtar/hartimin e tezës së SPA dhe mbrojtjen e saj

Në programin SPA në “Ortognatodonci”provimi final në përfundim të studimeve është parashikuar në këtë mënyrë: Udhëheqesi i Programit vlerëson performancën klinike të studentit duke u bazuar në aktivitetin klinik që studenti ka pasqyruar në librezën e studentit. Në këtë vlerësim hyn edhe sjellja e studentit ndaj pacientit, stafit si edhe kolegëve, impenjimi i tij në punën e drejtpërdrejtë mbi pacientin, por edhe ndjekja dhe asistimi në rastet klinike të trajtuara nga studentët e tjerë në grup, Përveç kësaj, çdo student përgatit tezën e diplomës ku pasqyrohet eksperiencia e fituar përgjatë 3 viteve të specializimit dhe ku duhet të prezantohet të paktën një rast klinik i nisur dhe përfunduar nga vetë studenti.

Provimi jepet përpara një komisioni të miratuar nga departamenti dhe ku kryetar i komisionit është Udhëheqësi i Programit

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 6- Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Informacionet e ofruara nga institucioni mbi programet e studimit, modulet dhe syllabuset janë lehtësisht të konsultueshme për studentët si në formë të shkruar dhe elektronike.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni bën të njohur si në formë të shkruar dhe elektronike rregulloret e ndryshme të pranimit të studentëve dhe të organizimit të programeve të studimit.</p>	<p>Intitucioni ofron të dhëna mbi programin e studimit, modulet dhe syllabuset nëpërmjet manifestit akademik, në ambjentet e universitetit, dhe në faqen <i>web</i> të universitetit http://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-mjekesore-2/.</p>

	<p>Institucioni ka rregullaret në lidhje me pranimin e studentëve dhe organizimin e programit. Ato i bëhen me dije studentëve nëpërmjet sekretarisë dhe faqes zyrtare në momentin e aplikimit. Gjithashtu pas hyrjes në program Koordinatori i Programit, gjatë javës së parë, bën një prezantim të organizimit të programit.</p>
<p>Standardi I. 7- Përmbatja e programeve të studimeve është e plotë dhe e qartë në përmbushje të objektivave të këtyre programeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të të gjitha kërkesave për përfundimin me sukses të studimeve, përfshirë këtu dhe kreditet (ECTS).</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të lëndëve të përgjithshme, lëndëve të specialitetit, përvojave klinike/praktike.</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të pikëve dhe notës minimale për përfundimin me sukses të lëndës/kursit.</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve përshihen në një koncept të përbashkët, në një "plan diplomimi"³.</p>	<p>Programi i studimit SPA në "Ortognatodonci" përmban një përshkrim të të gjitha kërkesave për përfundimin e studimeve. Studenti në fund të programit duhet të ketë fituar 180 ECTS.</p> <p>Programi i istudimit ka të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me lëndët e përgjithshme, lëndët e specialitetit si edhe praktikat klinike.</p> <p>Në syllabuset e lëndëve përshkruhen qartë mënyra e vlerësimit të studentit. Ky vlerësim shprehet në përqindje duke marrë në konsideratë frekuentimin aktiv të lëndës, modulet semestrale si edhe provimin final të lëndës. Nota minimale kaluese është nota 5 (pesë). Ky program studimi pasqyron detyrimet e studentit në lidhje me frekuentimin e lëndës si edhe parashikon penalitetet në lidhje me mosfrekuentimin e lëndës, si edhe kohën maksimale se deri kur mund të zgjatet ndjekja e programit.</p>
<p>Standardi I. 8- Institucioni bën vlerësimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Vlerësimi i programeve të studimit bëhet duke përcaktuar pikat e forta dhe dobësitë për arritjen e objektivit, si dhe sugjerimet për përmirësim në të ardhmen.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni bën vetëvlerësimin institucional nëpërmjet instrumentave dhe metodologjive matëse dhe vlerësuese, duke përfshirë gjithë procesin në një sistem të informatizuar.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një sistem të kodifikuar për klasifikimin dhe arkivimin (baza të dhënash në format elektronik, arkivim i dokumentacionit) e të dhënave të të gjitha aktiviteteve të zhvilluara dhe të rezultateve të arritura.</p> <p>Kriteri 4 Personeli akademik angazhohet në vlerësimin efektiv të programeve të studimit.</p>	<p>Albanian University, nëpërmjet Zyrës së NJBSC në fund të çdo viti akademik përgatit një raport të vlerësimit të brendshëm, i cili publikohet edhe në faqen zyrtare të ëeb-it të institucionit. Në këtë raport përfshihet edhe analiza SËOT.</p> <p>Institucioni bën vetëvlerësimin institucional duke analizuar nëpërmjet instrumentave dhe metodologjive matëse dhe vlerësuese.</p> <p>Në Albanian University dokumentat ruhen në arkivën e institucionit. Në programin e SPA në "Ortognatodonci", të dhënat në lidhje me punimet e kryera nga studentët në pjesën klinike përveçse dokumentohen në kartelat klinike dhe librezën e studentit ruhen edhe në format elektronik.</p> <p>Personeli akademik angazhohet në vlerësimin efektiv të programeve të studimit. Anëtarë të stafit akademik janë pjesë e grupeve të punës që përgatit raportin e vlerësimit të brendshëm. Në këtë vit akademik është përpiluar edhe një pyetësor për stafin në lidhje me vlerësimin e tyre për institucionin.</p>
<p>Standardi I. 10- Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli bëhet në përputhje me ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë (RSH), me ligjin për profesionet e rregulluara në RSH si dhe me direktivat europiane mbi profesionet e rregulluara.</p>	

³ "Plani i diplomimit" të studentit shpjegon kurrikulën, kurset që duhet të ndiqen për përfundimin e studimeve, mënyrën e frekuentimit të tyre në një afat të caktuar.

<p>Kriteri 1 Për kryerjen e programeve të studimeve specializuere afatgjata, studenti duhet të grumbullojë jo më pak se 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e këtyre programeve të studimeve është jo më pak se 2 vite akademike, në përputhje me ligjin e profesioneve të rregulluara.</p> <p>Kriteri 2 Kohëzgjatja minimale e programeve të studimit të specializimeve afatgjata nuk është më e vogël se ajo e përcaktuar në shtojcën I, bashkëlidhur këtyre standardeve.</p>	<p>Në përfundim të studimeve në programin SPA në “Ortognatodonci”, studenti grumbullon 180 kredite. Ky program studimi zgjat 3 vjet.</p>
<p>Standardi I. 11 - Hartimi dhe realizimi i programit të studimeve specializuere afatgjata në fushën e mjekësisë bëhet sipas kriterëve të parashikuara.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve specializuere afatgjata përfshijnë të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese, sipas specializimit përkatës, dhe 20% për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite sipas një programi të paracaktuar në fillim të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2 Në studimet specializuere janë parashikuar raportet e ECTS-ve për formimin e përgjithshëm dhe për atë specifik sipas skemës së mëposhtme në raport me ECTS-të totale minimale të parashikuara për programin specializues të paraqitur në shtojcën I:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2% për lëndë të formimit bazë për specializantin, - 2% për lëndë ndërdisiplinore ose integruese - 1% për aktivitete të tjera (lëndë informatike, gjuhë të huaja), - 5% për provimin final/temën eksperimentale të diplomës, - 30% për lëndë karakterizuese të fushës ku bën pjesë programi specializues (nga të cilat 15% e tyre duhet të jenë lëndë me zgjedhje) dhe - 60% për lëndë specifike të programit specializues (nga të cilat 15% e tyre duhet të jenë lëndë me zgjedhje). <p>Kriteri 3 Plani i detajuar mësikor është miratuar sipas akteve ligjore/nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 4 Në përfundim të çdo viti organizohet provimi vlerësues teorik dhe praktik i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor kryhet nga një komision i përbërë nga 5 (pesë) specialistë me përvojë të fushës përkatëse ose të përafërt me të sipas moduleve të zhvilluara. Studentët që vlerësohen negativisht 5 herë marrin një dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e specializimeve afatgjata. Studenti mund të riaplikojë për të konkuruar në një program tjetër specializues jo më shumë se 1 herë. Studentit mund t’i njihen ECTS-të e grumbulluara për studimet e organizuara teorike nga ana e Këshillit të Profesorëve nëse gjykohet se përputhen me fushën e programit të ri ku ai ka aplikuar.</p> <p>Kriteri 5 Studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar/final në përfundim të programit specializues i cili konsiston në testimin praktik dhe atë me gojë të studentit me kohëzgjatje prej të paktën 30 minutash si dhe paraqitjen e temës eksperimentale të diplomës. Për këtë ngrihet një komision i përbërë nga 5 specialistë të fushës, ose të një fushe të afërt, me eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën përkatëse, nga të cilët 2 të emëruar nga Ministri i Shëndetësisë, 1 nga Urdhri Profesional përkatës dhe 2 të emëruar nga fakulteti që ofron programin specializues. Kryetar i komisionit është një nga përfaqësuesit e emëruar nga Ministri i Shëndetësisë. Disa nga njohuritë bazë për të cilat aplikanti testohet në provimin përfundimtar, janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Zhvillimi i sensit kritik lidhur me situatat e ndryshme klinike; b. Lidhjet mes fushave të ndryshme të mjekësisë; c. Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin 	<p>Programi i studimit specializues afatgjatë në “Ortognatodonci” pranë Albanian University, përfshin 85% (pra mbi 80%) të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese, sipas specializimit përkatës, dhe 15% të ECTS-ve për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite sipas një programi të paracaktuar në fillim të programit të studimit.</p> <p>Në program janë parashikuar raportet e ECTS-ve për formimin e përgjithshëm dhe për atë specifik sipas skemës së mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2% për lëndë të formimit bazë për specializantin, - 2% për lëndë ndërdisiplinore ose integruese - 1% për aktivitete të tjera (lëndë informatike, gjuhë të huaja), - 5% për provimin final/temën eksperimentale të diplomës, - 29.4% për lëndë karakterizuese të fushës ku bën pjesë programi specializues (nga të cilat 18% e tyre janë lëndë me zgjedhje) dhe - 60.5% për lëndë specifike të programit specializues (nga të cilat 13.7% e tyre janë lëndë me zgjedhje). <p>Programit Studimit SPA në “Ortognatodonci” pranë Albanian University, ofrohet me një emër dhe kurrikul të ndryshuar për t’u përshtatur me aktet ligjore në fuqi. (Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 75, datë 18.02.2013; Udhëzimit Nr.31, datë 29.12.2017). Kjo kurrikulë u riorganizua me Vendim Senati Akademik Nr.18, datë 19.06.2018 nën masën 20% dhe u pranua nga MASR me shkresë Nr. 2635/1 Prot datë 19.07.2018.</p> <p>Në përfundim të çdo viti organizohet provimi vlerësues teorik dhe praktik i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor kryhet nga një komision i kryesuar nga Udhëheqësi i Programit dhe me anëtare specialistë me përvojë të fushës përkatëse ose të përafërt me të sipas moduleve të zhvilluara. Studenti në këtë program nuk lejohet të vazhdojë ndjekjen e programit, nëse koka e studimeve zgjat më shumë se 2-fishi i kohëzgjatjes së vetë programit. Studenti mund të riaplikojë për të konkuruar në një program tjetër specializues. Studentit mund t’i njihen ECTS-të e grumbulluara për studimet e organizuara teorike nga ana e Këshillit të Profesorëve nëse gjykohet se përputhen me fushën e programit të ri ku ai ka aplikuar.</p>

<p>gjatë punës në klinikë;</p> <p>d. d. Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e situatave klinike dhe për të dhënë zgjidhje në rastë emergjente.</p>	<p>Studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar/final në përfundim të programit specializues i cili konsiston në testimin praktik dhe atë me gojë të studentit me kohëzgjatje prej të paktën 30 minutash. Udhëheqësi i Programit nëpërmejt rasteve klinike të trajtuara nga student përgjatë 3 viteve, vlerëson performancën klinike, aktivizimin si individ dhe në grup të studentit, sjelljen me pacientët si edhe me kolegët. Në vlerësimin teorik student vlerësohet duke u bazuar në përgatitjen e temës së diplomës, e cila lidhet më rastet klinike të trajtuara nga studenti dhe ku të paktën njëri prej tyre duhet të paraqitet i përfunduar duke pasqyruar të gjithë problematikat dhe hapat e përfshira përgjatë trajtimit.</p>
---	--

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ pas vizitës në institucion ,njohjes me dokumentacionin përkatës konkludon se:

- Albanian University siguron një menaxhim efikas të informacionit në lidhje me programin e studimit SPA në Ortognatodonci”.
- Programi i studimit përmban kurrikulën me kredite, përshkrimin e lëndëve sipas specifikave të tyre, mënyrën e vlerësimit me notë në përfundim të detyrimeve akademike për secilën prej tyre.
- Institucioni bën vlerësimin institucional duke përpiluar edhe analizën SWOT në raportin e vlerësimit të brendshëm.
- Programi i studimit SPA në “Ortognatodonci” zgjat 3 vjet dhe në fund të tij studenti grumbullon 180 ECTS.
- Ndryshimi i emrit të programit si edhe në kurrikulën e tij, janë bërë në përshtatje me Standardet shtetërore të cilesise per programet SPA, por në thelb misioni, qëllimi dhe objektivat e programi janë vazhdim i programit SPA në “Orthodonci”, i cili është ofruar nga ky institucion që prej vitit 2012.

8. Mësimdhënia - mësimnxënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia organizohet në bazë kursi për leksionet dhe në formë grupi ose nëngrupi për punët laboratorike dhe praktikat klinike.

Pjesën më të madhe të ngarkesës në planin mësimor e zënë praktikat klinike kurse pjesa tjetër i përket leksioneve, kërkimit shkencor apo aktiviteteve të tjera. Leksionet zhvillohen në sallat e leksioneve të cilat janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme didaktike. Pjesa klinike e programit realizohet në sallat klinike të pajisura me poltrona dentare dhe ku ofrohen të gjitha mjetet dhe materialet për punën me pacientët.

Për të ofruar një mësimdhënie sa më cilësore dhe me synim rritjen e cilësisë, edhe studentet e këtij programi përfshihen në analizat dhe kontrollet që NJBSC realizon nëpërmjet pyetësorëve online apo focus grupeve.

Studentët nën mbikqyrjen e tutorëve mund të trajtojnë pacientët që paraqiten për trajtim ortodontik pranë Klinikës Universitare.

Studentëve që në fillim të vitit akademik njihem me rregulloren e institucionit dhe të SPA . Ata janë të detyruar të frekuentojnë aktivitetet formuese të paktën deri në masën 75%. Studenti nuk pranohet në sesionin

e parë të provimit të një lënde kur ka kryer më shumë së 25% mungesa në seancat mësimore të asaj lënde. Nëqoftëse ai ka kryer deri në 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës, atëherë ai pranohet në sesionin e dytë. Nëse ka kryer mbi 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës shpallet përsëritës në atë lëndë.

Kontrolli i njohurive të studentëve përcaktohet në Rregulloren Mësimore të Programit të studimit dhe në syllabusin e çdo lënde.

Tregues të matshëm:

Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies (Tabela 11 në aneks)

Pjesa më e madhe e ngarkesë mësimore i përket praktikave klinike (72 %) dhe pjesa tjetër leksione (4.5 %), kërkim shkencor (9.5 %), pune e pavarur (13.5 %).

Format e kontrollit të njohurive (Tabela 12 në aneks)

Vlerësimi final për lëndën e ndjekur bëhet në vazhdimësi duke marrë në konsideratë frekuentimin aktiv të lëndës (10%), plotësimi i detyrave të kursit (10%), testimet gjatë vitit (20%) dhe provimi përfundimtar (60%).

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj. (Tabela 13 në aneks)

Vihet re se përfshirja e personelit akademik në aktivitetin shkencor. Pjesëmarrja në projekte shkencore është evidente. Ato janë zhvilluar kryesisht në nivel Fakulteti dhe më pak në nivel Departamenti apo SPA.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 9- Institucioni përdor instrumente matës, vlerësues, metodologji vlerësimi.	
<p>Kriteri 5 Institucioni për kryerjen e vlerësimit përdor instrumente/metoda vlerësimi të drejtpërdrejta ose të tërthorta.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Ndjekje të studentëve gjatë zhvillimit të praktikave dhe angazhimi i tyre në ndjekjen e rasteve klinike konkrete; Vlerësimi me nota/pikë në fund të çdo viti; Testime paraprake dhe dytësore: provime për module, praktikë; Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës; Vlerësimi përfundimtar. <p><u>Të tërthorta</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhet: të studentëve të rinj/të vjetër, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të kurrikulës (pjesës teorike dhe asaj praktike, kapaciteteve logjistike infrastrukturore dhe të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, etj.); Intervista. <p>Kriteri 6 Institucioni disponon një sistem të kodifikuar për klasifikimin dhe arkivimin (baza të dhënash në format elektronik, arkivim i dokumentacionit) e të dhënave të të gjitha aktiviteteve të zhvilluara dhe të rezultateve të arritura.</p>	<p>Studentët vlerësohen me notë pas plotësimit të detyrimeve akademike në lëndën përkatëse. Në këtë vlerësim merret në konsideratë frekuentimi aktiv I lëndës, provimet semestrale si edhe pikët e grumbulluara nga provimi final. Udhëheqësi i programit gjithashtu merr në konsideratë edhe performancën e studentit me pacientët që trajton.</p> <p>Për vlerësimin e tij, institucioni 2 herë në vit, nëpërmjet Zyrës së NJBSC, organizon një pyetësor online përpara sezonit të provimeve. Gjithashtu aplikohen edhe intervista, fokus grupe, etj. Kriteri 6 Baza e të dhënave për studentët dhe realizimet e tyre ruhen në format elektronik, arkivim i dokumentacionit është nën kujdesin e sekretariës mësimore dhe kryesekretarisë FSHM.</p> <p>Institucioni disponon një sistem të kodifikuar për klasifikimin dhe arkivimin e të dhënave të të gjitha aktiviteteve të zhvilluara dhe të rezultateve të arritura.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ pas vizitës në institucion, njohjes me dokumentacionin përkatës konkludon se:

- Mësimdhënia në programin e studimit afatgjatë në "Ortognatodonci" organizohet në kurse, grupe dhe nëngrupe. Në ngarkesën mësimore pjesën më të madhe e zënë praktikat klinike.
- Vlerësimi i studentit për lëndën kryhet me notë vetëm nëse ai ka përmbushur detyrimet akademike. Në

vlerësimin e studentit merren në konsideratë: frekuentimi aktiv i lëndës, plotësimi i detyrave dhe laboratoreve si edhe provimi final.

- Ky program studimi është pjesë e integruar e vetëlerësimit të institucionit, proces i cili realizohet dhe monitorohet nga NJBSC.

9. Studentët e SPA

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi në ciklin e tretë të studimit për programin e studimit specializim aftgjatë në “Ortognatodonci ” në AU bëhet në përputhje me Ligjin nr. 80 22.07.2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe aktet nënligjore mbi arsimin e lartë në fuqi.

GVJ u njoh me procedurën e pranimit dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për tu pranuar në programin e specializimit aftgjatë në “Ortognatodonci”.

Studentët që pranohen në programin e specializimit aftgjatë “Ortognatodonci ”duhet te kene:

- Diplomë “Master i Shkencave” në Stomatologji.
- Diplomë tjetër ekuivalente me diplomën e mësipërme, si psh: diplomë e sistemit të vjetër të pandarë në cikle studimi (Kopje e noterizuar), si dhe Diplomë e përfituar jashtë vendit e vlerësuar ekuivalente me diplomat e mësipërme. (Në rastin e një diplome të përfituar në Universitete jashtë vendit duhet të paraqitet njehsimi i saj nga MASR).
- Të ketë kryer me sukses provimin e shtetit konform ligjit 1017, dt. 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe të ketë përftuar të drejtën e ushtrimit të profesionit përkatës në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj.
- Listë notash të shkollës së lartë; (origjinale ose fotokopje e noterizuar).
- Notë mesatare të notave të ponderuara me kreditit e të gjitha viteve të programit të studimeve jo më të vogël se 6 (gjashtë)
- CV të detajuar,
- fotokopje e kartës së identitetit,
- Dëshmi e marrjes së njëres prej 5 gjuhëve të huaja sipas pikës 3 të nenit 78 të ligjit 80/2015 të certifikuar në nivelin internacional, sipas përcaktimeve të udhëzimit përkatës të MASR dhe akteve nënligjore në fuqi.

Kohëzgjatja normale e studimeve është 3 vite akademike. Afati maksimal i përfundimit të studimeve të plota është dyfishi i afatit të rregullt, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studentit i ka pezulluar studimet. Studenti lejohet të regjistrohet në vitin pasardhës, kur ka fituar të paktën 50% të krediteve të detyrueshme të vitit paraardhës. Lëndët të cilave u përkasin kreditet e mbetura konsiderohen detyrime të mbartura.

Gjatë vitit akademik 2014–2017 në Programin SPA në “Ortodonci” janë regjistruar 30 specializantë, me notë mesatare 8.4. Brezi i studentëve 2014-2017 (30 studentë) megjithëse u përfshinë gjatë vlerësimit për akreditimin e parë nuk përfituan nga vendimi i akreditimit (shih Akreditimi i parë: VBA Nr. 29, datë 19.05.2017). Gjatë vizitës në Institucion u deklarua se ato nuk kane mbrojtur akoma Tezën e Diplomës

Gjatë vitit akademik 2018–2019 në Programin SPA në “Ortognatodonci” janë regjistruar 28 specializantë, me notë mesatare 7.5.

Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Procedura e pranimit të studentëve bëhet sipas Nenit 26 të Rregullores së programit të studimit. Kjo procedurë realizohet si më poshtë.

- Dokumentet për konkurrim pranohen sipas njoftimit publik për pranimin e aplikimeve.
- Dokumentet për konkurrim dorëzohen nga i interesuari në Sekretarinë e specializimeve; Me dorëzimin e dokumenteve aplikanti merr një formular aplikimi (evidence II.10) si dhe informohet në mënyrë të detajuar mbi programin e specializimit. Specializanti duhet të informohet mbi: kohëzgjatjen e programit të studimit; kushtet që duhet të plotësojë specializanti përpara paraqitjes në provimin përfundimtar; mbështetjen që institucioni i siguron specializantit nëpërmjet strukturave administrative dhe kërkimore për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit (laboratorë, biblioteka, etj.);
- Fitues shpallen kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të pikëve në rend zbritës deri në plotësimin e kuotës së parashikuar të pranimit.
- Pikët totale janë 100 të cilat ndahen si më poshtë:
 - 50 pikë intervista me gojë
 - 30 pikë kurse kualifikimi në përputhje me specialitetin
 - 20 pikë mesatarja e notave
- Pas llogaritjes së pikëve departamenti bën publike rezultatet dhe i komunikon fituesve afatet e regjistrimit.
- Aplikanti fiton statusin e specializantit me përfundimin e procedurave të regjistrimit;

Kushte specifike të pranimit të studentëve

Albanian University mundëson transferimin e specializantëve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të tretë, midis programeve të njëjta ose të ngjashme studimi, si brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, private ose publike, vendase ose të huaja, si dhe lejon transferimin e specializantëve të saj në shkolla të tjera të arsimit të lartë sipas procedurave të parashikuara në këtë rregullore. Këto institucione duhet të jenë të akredituara për kryerjen e programit specializues në vendin përkatës. Procedura e transferimit bëhet në përputhje me Rregulloren e Transferimeve.

Të dhëna statistikore për studentët e pranuar:

- Në 87 studentë të regjistruar gjithsej (për të gjitha vitet) me mesatare në hyrje 7.5:
 - brezi i parë 2012-2015 (24 specializantë),
 - brezi i dytë 2014-2017 (30 specializantë),
 - brezi i tretë 2018-2019 (28 specializantë)

Vetëm 17 studentë kane arritur të përfundojnë programin pa vite përsëritëse duke patur mesatare 8.9 në dalje. Numri total i të Diplomuarve është 17 dhe i përket brezit 2012-2015.

- Numri i specializantëve të regjistruar që vijnë nga jashtë njësisë që ka hapur programin e studimeve të SPA është zero.
- Kohëzgjatja mesatare e studimeve të SPA dhe cila ka qenë tendenca e këtij treguesi;

- brezi i parë 2012-2015 17 të diplomuar nga 24 që nisën specializimin
- brezi i dytë 2014-2017 5 studentë nga 30 në total kanë kaluar në stazh (2 v II dhe 3 v III)
- 0 % është numri i specializantëve në nivel programi studimesh, që kanë ndërprerë studimet e SPA.
- 15,5 % është numri i specializantëve të regjistruar, që vijnë nga Kosova dhe trojet shqiptare, si edhe nga diaspora shqiptare;
- 18 % është numri i specializantëve të regjistruar, që vijnë nga trojet shqiptare, dhe nga diaspora shqiptare;
- 0% është numri, i specializantëve të regjistruar që vijnë nga rajoni i Ballkanit;
- 0% është numri, i specializantëve të regjistruar që vijnë nga vendet e BE-së;
- 0% është numri, i specializantëve të regjistruar që vijnë nga vende të tjera të botës

Të dhëna për mobilitetin e studentëve specializantë në Universitetet jashtë vendit (Tabela 15, në aneks)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 13- Pranimi i studentëve në një program studimi specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë	
<p>Kriteri 1 Studenti i pranuar në programin e studimit specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë ka përfunduar programin e integruar të studimeve universitare të integruara të ciklit të dytë me kohëzgjatje 5 vjeçare (300 ECTS) për degët Farmaci dhe Stomatologji dhe 6 vjeçare (360 ECTS) për degën Mjekësi e përgjithshme, pranë një universiteti të akredituar për programin në fjalë dhe ka fituar diplomën universitare “Master i Shkencave”. Për studentët e diplomuar në të njëjtat degë jashtë shtetit të cilëve u njihet diploma për ushtrimin e profesionit përkatës në këto vende, nuk ka kriter për notën mesatare për t’u pranuar në programet e specializimeve afatgjata në mjekësi. Lista e vendeve më sipër përcaktohet me udhëzim të përbashkët të MASH dhe MSH.</p> <p>Kriteri 2 Kandidati që aplikon për të vazhduar programin e studimeve të ciklit të tretë, për specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë, i nënshtrohet një konkursi pranimi për të testuar njohuritë në fushën përkatëse të studimit.</p> <p>Kriteri 3 Vlerësimi i studentit për pranimin në një program studimi bëhet me pikë duke vlerësuar notën mesatare (notën përfundimtare sipas tipologjisë së diplomës që ai disponon) për jo më shumë se 20% të pikëve totale, testimin e përgjithshëm me shkrim për 30-40% të pikëve totale, testimin me shkrim specifik sipas programit të specializimit për të cilin konkuron për 40-50% të pikëve totale, intervistën me gojë për jo më shumë se 10-20% të pikëve totale duke përfshirë këtu, eventualiasht, dhe letrat e rekomandimit nga profesorë të fushës të cilët deklarojnë se kanë patur bashkëpunim shkencor me kandidatin. Kohëzgjatja e provimit me gojë nuk mund të jetë më e shkurtër se 30 minuta.</p> <p>Kriteri 4 Studenti duhet të ketë përfunduar me sukses provimin e shtetit në profesionin përkatës ose të ketë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në RSH ose jashtë saj (e njohur në RSH). Në rastet kur nuk e ka përfunduar ende provimin e shtetit pranohet me kusht që ta përfundojë atë me sukses brenda vitit të parë të specializimit, në të kundërt përjashtohet nga specializimi dhe shlyen financiarisht pagesat eventuale që ka përfutur gjatë specializimit.</p> <p>Kriteri 5 Këshilli i Profesorëve përcakton kriteret për t’u pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata të pasqyruara në rregulloren e programit të studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë dhe të aprovuara nga Senati Akademik, Rregullorja e specializimit</p>	<p>Studentët e pranuar në ciklin e tretë të studimit për programin specializim afatgjatë në “<i>Ortognatodonci</i>” kanë notën mesatare mbi 6 dhe Diplomë “Master i Shkencave” në Stomatologji.</p> <p>Proçedura e pranimit bëhet sipas Nenit 26 të Rregullores se programit të studimit: pranimi i dokumentacionit, konkurrimi, shpallen kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të pikëve në rend zbritës deri në plotësimin e kuotës së parashikuar të pranimit.</p> <p>Vlerësimi i studentit për pranimin në këtë program studimi bëhet me pikë. Pikët totale janë 100 të cilat ndahen si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 50 pikë intervista me gojë - 30 pikë kurse kualifikimi në përputhje me specialitetin - 20 pikë mesatarja e notave <p>Në këtë fazë departamenti bën publike rezultatet dhe i komunikon fituesve afatet e regjistrimit.</p> <p>Aplikanti fiton statusin e specializantit me përfundimin e proçedurave të regjistrimit</p> <p>Vlerësimi i studentëve për pranim në këtë program nuk bëhet sipas kriterit 3.</p> <p>Nuk bëhet :</p> <ul style="list-style-type: none"> - testimi i përgjithshëm me shkrim për 30-40% të pikëve totale - testimi me shkrim specifik sipas programit të specializimit 40-50% të pikëve totale - intervista me gojë vlerësohet me 50 pikë kur në kriter është jo më shumë se 10-20% të pikeve totale <p>Studenti paraqet Liçensën, provimin e shtetit konform ligjit 1017, dt. 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalentimin e njohur në Republikën e</p>

<p>duhet të ketë marrë pëlqimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Kriteri 6 Aplikanti merr paraprakisht informacion të detajuar për programin e studimit specializues, para se të pranohet në të.</p>	<p>Shqipërisë.</p> <p>Kriteret për t'u pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata të pasqyruara në rregulloren e programit të studimeve të specializimeve afatgjata në Ortognatodonci janë aprovuara nga Senati Akademik me Vendim Nr.47, Protokoll Nr.937prot, date 28.09.2018. (evidencë I.3)</p> <p>Aplikanti merr paraprakisht informacion të detajuar për programin e studimit specializues dhe fiton statusin e specializantit me përfundimin e procedurave të regjistrimit.</p>
<p>Standardi V. 1- Studenti që ka përfunduar një program të integruar të studimeve në fushat e mjekësisë, farmacisë, stomatologjisë, plotëson standardet akademike të kriterëve të pranimit të institucionit respektiv dhe gëzon të drejtën për t'u regjistruar në programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.</p>	
<p>Kriteri 1 Aplikanti që kërkon të pranohet në programin e studimeve specializues ka parashtruar kërkesën për një fushë të veçantë specializimi dhe i nënshtrohet provimit të pranimit në programin e studimit specializues për të cilin ka aplikuar.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një model teorik të informatizuar për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësisë të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme (operativ, konjitiv e relacionues).</p> <p>Kriteri 3 Institucioni shpall paraprakisht programin e parashikuar për provimin e pranimit dhe instrumentat që përdor për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësisë të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni vlerëson në mënyrë të vazhdueshme politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Aplikanti që kërkon të pranohet në programin e studimeve specializues me dorëzimin e dokumenteve merr një formular aplikimi (evidence II.10) në të cilën specifikon specialitetin që do të pranohet dhe për të cilin do të konkurojë.</p> <p>Ne procedurën e pranimit realizohet intervista me gojë e cila vlerësohet deri në 50 pike e cila vlerëson njohuritë dhe aftësitë e ndryshme konjitive, komunikative dhe operative të aplikantit.</p> <p>Institucioni shpall Fitues kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të pikëve në rend zbritës deri në plotësimin e kuotës së parashikuar të pranimit.</p> <p>Në takimet në institucion drejtuesit ishin të angazhuar për të përshtatur pikëzimin në procedure e pranimit me atë të kriterëve të standartit.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin dhe të dhënat e studentëve që ndjekin programet e studimit specializuese afatgjata.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një pasqyrë të përvitshme për numrin e të diplomuarve, në programet specializuese afatgjata, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni zotëron të dhëna individuale për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi (notat e mëparshme p.sh. vlerësimin e studentëve në programin e mëparshëm të studimit, etj.).</p>	<p>GVJ konstatoi se institucion disponon të dhëna mbi numrin e të regjistruarve, të transferuarve dhe të larguarve nga programi i studimit të ciklit të tretë SPA në "Ortognatodonci" si dhe për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>
<p>Standardi V. 3- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studenti informohet në mënyrë të detajuar për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit.</p> <p>Kriteri 2 Studenti informohet për rezultatet e vlerësimit. Ato publikohen në ambientet e fakultetit.</p>	<p>Studentët informoheshin që në javën e parë (orientation ëcek)nga udhëheqësi, drejtuesi ,tutoret e SPA Ortognatodonci në mënyrë të detajuar për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit,statusin e akreditimit, etj.</p> <p>Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit nga pedagogët gjatë dhe në përfundim të programit Rezultatet e vlerësimit diskutohen me studentët .</p>
<p>Standardi V. 5 - Studenti ka të gjitha kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studenti i pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata ka kushtet e nevojshme për të realizuar</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe njohjes me dokumentacionin GVJ</p>

(Handwritten signatures)

<p>programin e studimit me karakter akademik e klinik.</p> <p>Kriteri 2 Programi i studimeve specializuese afatgjata siguron harmonizim të synimeve të studentit në fushën klinike dhe kërkimore-shkencore dhe, në përfundim të tij, edhe të mundësisë për karrierë profesionale ose punësim.</p> <p>Kriteri 3 Studenti që ndjek programet specializuese afatgjata të studimit ka në dispozicion një bibliotekë shkencore të pasur me botime në letër dhe në formë elektronike si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së.</p> <p>Kriteri 4 Studenti ka mbështetje teknike të mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit klinik dhe kërkimor të lidhur me të.</p> <p>Kriteri 5 Hulumtimet që kanë të përfshira kërkime laboratorike mbështeten me bazë laboratorike të mjaftueshme.</p> <p>Kriteri 6 Studenti është i siguar gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin specializues. Për këtë disponohet dokumentacion i mjaftueshëm nga institucioni. Një kopje e policës së sigurimit i dorëzohet studentit në momentin e lidhjes së saj.</p>	<p>konstaton se FSHM dhe Klinika Universitare Stomatologjike ka kapacitetet e duhura për realizimin teoriko-klinik të këtij programi.</p> <p>Programi i studimeve specializuese afatgjata siguron harmonizim të synimeve të studentit në fushën klinike dhe kërkimore-shkencore dhe, në përfundim të tij, specialistët do të kenë mundësi të ndjekin karrierën si specialist ortodonte në klinika dentare, qendra spitalore, pedagogë në programe akademike, drejtues kursesh formimi afat gjatë dhe afat shkurtër, si hartues programesh dhe projektesh mësimore dhe studimore në fushën e stomatologjisë,</p> <p>Studenti që ndjek programet specializuese afatgjata të studimit ka në dispozicion një bibliotekë shkencore të pasur me tituj librash profesional dhe literature në format elektronike si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së.</p> <p>Studentet mbikqyreshin dhe asistoheshin në aktivitetin klinik dhe kërkimor nga tutorë të specializuar dhe me grada shkencore, me experience të gjatë klinike dhe akademike dhe udhëheqësi i programit Prof. Giovanni Manes Gravina me vlera të spikatura akademike.</p> <p>Praktikat paraklinike dhe klinike në kukulla apo në paciente realizohen në salla klinike dhe paraklinike të Klinikës Universitare të pajisura me aparatura bashkëkohore, instrumentar dhe materiale dentare cilësore duke bërë të mundur kryerjen cilësore të aktivitetit praktik të specializantëve të këtij programi specializimi.</p> <p>Studenti është i siguar gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin specializues. (evidencë II.18) duke u pajisur me kopjen e policës së sigurimit.</p>
---	---

Standardi V. 6- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e studentëve që kanë përfunduar programet e studimit specializuese afatgjata.

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar dhe vendet e punësimit.</p>	<p>GVJ u takua me anëtarët e “Zyra e Karrierës dhe Alumnit” (ZKA). Kjo zyrë ofron këshillim karriere gjithë studentëve, dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor nëpërmjet sistemit të tutoriatit. Ajo mbështet në mënyrë aktive të diplomuarit në planet e tyre për karrierën dhe përshtatjen me tregun e punës si dhe mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar .</p>
---	--

Standardi V. 7- Institucioni ndjek procedura të qarta për vlerësimin e njohurive të studentëve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura të qarta dhe transparente për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentit, të përcaktuara dhe të bëra të ditura që në fillim të programit të studimeve në rregulloren e specializimit.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin e njohurive të marra nga studentët gjatë programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3 Konkluzionet e vlerësimit në vazhdimësi, janë të qarta dhe transparente, përfshirë pezullimin, zgjatjen ose përjashtimin nga studimet specializuese.</p> <p>Kriteri 4 Vlerësimi vjetor i studentëve bëhet sipas moduleve</p>	<p>Ndiqen procedura të qarta dhe transparente për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentit, të përcaktuara dhe të bëra të ditura që në fillim të programit të studimeve në rregulloren e specializimit dhe syllabuset e lëndëve përkatëse.</p> <p>Dija e studentit kontrollohet nëpërmjet kontaktit të vazhdueshëm të pedagogut me studentin në formën e bashkëbisedimit, të testimeve sipas moduleve që ka ndjekur specializanti gjatë vitit akademik ose seancave të kontrollit të dijes, të parashikuara në rregulloren e programit të studimit neni 37- neni 43 përfshirë</p>
---	--

që ka ndjekur specializanti gjatë atij viti akademik.	pezullimin, zgjatjen ose përjashtimin nga studimet specializuese. Rezultatet e vlerësimeve të marra nga studentët gjatë programit të studimit ruhen ne Sekretarine mësimore.
---	---

Standardi V. 8 - Vlerësimi përfundimtar i studentëve

<p>Kriteri 1 Studenti jep prova që ka fituar:</p> <ol style="list-style-type: none"> Njohuri të thelluara në fushën përkatëse; Njohuri të thelluara në disa fusha të afërta me të; Aftësi profesionale dhe shkencore në përdorimin e teknologjisë bashkëkohore për të zgjidhur problemet klinike që lidhen me fushën e tij të specializimit dhe integrimin e njohurive të fituara për zgjidhjen e situatave komplekse; Risi, për të zgjeruar dhe për të rifreskuar njohuritë ekzistuese; Autonomi, integritet shkencor, profesional dhe përkushtim për zhvillimin e ideve të reja; Aftësi bashkëpunimi në grup për zgjidhjen e situatave të ndryshme klinike; Sjellje etike dhe profesionale. <p>Kriteri 2 Studenti jep prova që me anë të punës së tij klinike ka fituar aftësinë dhe kompetencat profesionale dhe shkencore të nevojshme për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur.</p> <p>Kriteri 3 Studentit i jepet e drejta për të hyrë në provimin përfundimtar pas shqyrtimit të dosjes së tij nga këshilli i programit specializues i cili e vlerëson atë pozitivisht ose negativisht. Dosja e kandidatit përmban vlerësimet mbi praktikën dhe modulet e kryera si dhe vlerësimet periodike nga ana e tutorit. Në rast vlerësimi negativ nga këshilli i programit specializues, studentit i komunikohet vendimi si dhe pjesët që duhet të përsërisë në mënyrë që të mund të hyjë në provimin përfundimtar.</p> <p>Kriteri 4 Vlerësimi përfundimtar i specializantëve bazohet në rezultatet e vlerësimeve periodike vjetore, në provimin përfundimtar dhe temën eksperimentale të diplomës si dhe gjykimin e pedagogëve dhe të udhëheqësit.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin final të njohurive të marra nga studentët.</p>	<p>Studentët japin prova që kanë fituar njohuri në fusha ku përfshihen shkencat mjekësore klinike, embriologjia, periodontologjia, ortodontia, patologjia orale, sëmundje të brendshme etj.</p> <p>Rendesi i kushtohet diagnozës diferenciale mes patologjive primare dhe atyre sekondare, Studiohen në veçanti deformimet dento – faciale, problemet skeletale kongjenitale apo te sindromave.</p> <p>Studentët janë të ndarë në grupe nga 3 dhe drejtohen nga një tutor duke trajtuar raste te ndryshme klinike dhe zgjidhur situata tv vecanta nëpërmjet bashkëpunimit mes tyre,shkëmbimit të njohurive.</p> <p>I kushtohet rëndësi nga ana e tutorëve dhe drejtuesve komunikimit etik dhe profesional studentë-pacientë, studentv – studentë.</p> <p>Studentët gjatë viteve i nënshtrohen vlerësimeve semestrale për përvetësimin e aftësive praktike profesionale dhe shkencore të nevojshme për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur.</p> <p>Studentit i jepet e drejta për të hyrë në provimin përfundimtar pas përmbylljes me sukses të të gjitha detyrimeve akademike. Në rast vlerësimi negativ studentit i komunikohen detyrimet përsëritëse, modaliteti i realizimit të tyre.</p> <p>Vlerësimi përfundimtar i specializantëve bazohet në rezultatet e vlerësimeve periodike vjetore, vlerësimin e performancës në praktikën klinike, performancës në provimin përfundimtar dhe temën eksperimentale të diplomës si dhe gjykimin e pedagogëve dhe të udhëheqësit.</p> <p>AU disponon të dhëna të plota për çdo student dhe vlerësimet akademike të tij në vite në rrugë elektronike.</p>
--	---

Standardi VI. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p>Kriteri 1 Biblioteka vë në dispozicion të programit të studimit një listë titujsh aktualë të literaturës së detyruar, e cila ndodhet realisht në bibliotekë.</p> <p>Kriteri 2 Biblioteka zotëron një listë të botimeve periodike dhe programeve kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit.</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të.</p> <p>Kriteri 4 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>GVJ vizitoi ambientet e bibliotekës e pasur me tituj librash profesionale (338 tituj librash në fushën e shkencave mjekësore me rreth 1436 kopje (evidencë IX.1).</p> <p>Në bibliotekë gjendet literatura e detyruar për programet mësimore, literaturë ndihmëse e mjaftueshme dhe bashkëkohore.</p> <p>Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Mjekësore vë në dispozicion të studentëve të SPA në “Ortognatodonci” rreth 143 tituj librash në fushën stomatologjike, (evidencë IX.2) 25 janë specifike të fushës specializuese me format e-book pdf në gjuhën angleze (evidencë IX.3). Në bibliotekë gjendet edhe 44 tituj të tjerë librash</p>
---	---

	<p>në gjuhë angleze për specializantët.</p> <p>Në dispozicion të studentëve janë vënë një sërë librarish on line si: “Cambridge Journals” www.cambridge.org/core; “Questia” www.questia.com; “Elsevier” www.textbooks.elsevier.com, ERIC të cilat janë të aksesueshme nën kujdesin e punonjësës së bibliotekës, në qendrën e internetit.</p> <p>Kjo literaturë ndihmon specializantët për realizimin me sukses të programit mësimor, të projektit kërkimor shkencor si dhe për përgatitjen e temës së diplomës.</p> <p>Çdo fillim viti akademik, njesitë bazë në përputhje me rishikimet e syllabuseve, bëjnë kërkesa për tituj librash dhe numër të tyre. Biblioteka e Fakultetit është e hapur çdo ditë të javës nga e hëna në të shtunën me orar të shpallur në ambjentet e fakultetit.</p>
--	---

Standardi VI. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë, mjedise të përshtatshme mësimore dhe struktura klinike.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka laboratorë, klasa, zyra, studio, auditore dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit.

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit, si dhe në përmirësim të vazhdueshëm.

Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion të studentëve strukturat klinike pjesë e rrjetit formues për zhvillimin optimal të programit specializues.

Në funksion të programit ka klasa, laboratorë mësimore të pajisur me aparaturë, pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që janë të përshtatshme për mësimdhënie dhe kërkim shkencor në përputhje me qëllimet e programit

Praktikat klinike të programit realizohen në ambjentet klinike të Klinikës Universitare Stomatologjike të pajisur me aparaturë dentare, instrumentar, materiale dentare.

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ pas vizitës në institucion dhe njohjes me dokumentacionin përkatës konkludon se :

- pranimi në ciklin e tretë të studimit për programin specializim afatgjatë në “Ortognatodonci” bëhet në përputhje me ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe urdhërat dhe udhëzimet që nxjerr Ministria e Arsimit.
- aplikimi, konkurimi dhe përzgjedhja bëhen sipas kriterëve dhe procedurave të paraqitura në rregulloren e programit të studimit.
- institucioni informon studentët e SPA Ortognatodonci në mënyrë të detajuar për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit, etj
- institucioni dispononte statistika për numrin e studentëve të rregjistruar, të çrregjistruar, të larguar për programin e specializimit afatgjatë në “Ortognatodonci”
- institucioni ndjek procedura të qarta dhe transparente për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentit. Institucioni dispononte të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë ndjekjes së studimeve që nga pranimi i tyre
- pranë institucionit funksionon e “Zyra e Karrierës dhe Alumnit” (ZKA).që asiston studentët me politikat e punësimit dhe ka një bazë të dhënash të studentëve të punësuar.
- në bibliotekë ka në dispozicion të programit të studimit një listë të pasur titujsh librash të literaturës së rekomanduar për këtë program studimi.
- institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve laboratorë, mjedise mësimore dhe struktura klinike të pajisura më së miri për realizimin e këtij programi studimi.

POLITIKA E KERKIMIT SHKENCOR TË INSTITUCIONIT

10. Kërkimi shkencor dhe përfshirja në kërkime të studentëve të SPA.

Pjesa përshkrimore:

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Në programin e SPA në "Ortognatodonci" rëndësi i kushtohet zhvillimit të kërkimit shkencor. Stafi akademik i angazhuar për realizimin e këtij programi ka tituj dhe grada shkencore (profesorë, profesorë të asociuar, doktorë shkencash, Phd) të fituara brenda dhe jashtë vendit në universitete të njohura.

Stafi i huaj me kontribute shkencore i përfaqshuar nga emra të njohur në fushën e Ortodoncisë i rrit vlerat këtij programi.

Departamenti i Stomatologjisë, Këshilli Drejtues i SPA Ortognatodonci, ka respektuar standardin për cilësinë e personelit të angazhuar në këtë program studimi.

Çdo syllabus është i pajisur me elemente të kërkimit shkencor. Studentët në lëndët e specialitetit bëjnë analizat të rasteve të ndryshme klinike, prezantime në poëer point të tyre, mbledhin të dhëna në lidhje me prevalencat e anomalive të ndryshme. Një pjesë të tyre i prezantojnë në konferencat shkencore që organizon institucioni dhe në aktivitete të tjera shkencore.

Ata nxiten dhe asistohen të marrin pjesë aktive në punime të ndryshme shkencore.

Lënda "Metodat e Kërkimit Shkencor", e cila është pjesë e kurrikulës së specializimit i pajis studentët me njohuritë e duhura në fushën e kërkimit shkencor duke i ndihmuar në realizimin e punimeve të tyre me karakter shkencor si dhe në përgatitjen e temave të diplomave.

AU organizon çdo vit konferencën vjetore të shkencave mjekësore dhe publikon revistën periodike "OPTIME" e cila përmban artikuj shkencorë të pedagogëve dhe specialistëve të ortognatodoncisë.

Në bashkëpunim me Universitetin e Aquilas – Itali janë zhvilluar 3 Kongrese për Patologji Orale. Kongresi i parë dhe i tretë në Shqipëri, kongresi i dytë në Avenzano me pjesëmarrje aktive të stafit akademik dhe studentëve të programit SPA Ortognatodonci.

Veprimtaria kërkimore shkencore në këtë Institucion bazohet:

- në realizimin e kërkimit shkencor nëpërmjet projekteve,
- në mbështetjen e veprimtarisë së stafit akademik, aftësimin dhe kualifikimin e tij,
- në integrimin e kërkimit shkencor në mësimdhënie,
- në krijimin e shprehive dhe të metodave kërkimore shkencore tek specialistët.

Në kuadër të këtyre objektivave, veprimtaria kërkimore shkencore orientohet në:

- pjesëmarrje dhe fitim të projekteve në nivel Institucional. Për vitin akademik 2018-2019 në fazat e fundit të nënshkrimit është projekti "Improving disaster Risk skills and Resilience-building Practices in Western Balkans": EMS Web -bashkëpunim i Albanian University dhe Instituti i Shëndetit Publik (evidencë X.1).
- pjesëmarrje në projekte individuale të pedagogëve të si psh. pedagogu B. Gjonaj me projektin "Blowup – Burning Tumours with light via optical Wave front Shaping and Photo-acoustic Feedback.
- organizmi i Konferencës XIV Ndërkombëtare të Departamentit të Stomatologjisë, në bashkëpunim me Universitetin e Pisës dhe Federico II të Napolit, për vitin akademik 2017-2018, pjesëmarrës në këtë konferencë ishte edhe specialisti Y.Menga (evidencë X.2).
- pjesëmarrje në Takimin e IV të Ortodontëve Shqiptarë maj 2017 prezantimi i studentit Y.Menga me temë "Përdorimi i miniimplanteve në Ortodonci" (evidencë X.3).

- pjesëmarrje në Konferenca Ndërkombëtare si ajo e BASS (Balcan Stomatological Society) për vitin akademik 2016-2017 studentja I.Gibrizi mori pjesë me prezantim Orthodontics in adults as a pre-prosthetic treatment – a clinical case report.(evidencë X.4)
- 21 Annual World Dental Summit në Shkurt të 2018 ku specializantja Tringa Shehu prezantoi temën “ Reviewing excellence in dental world”(evidencë R.12).
- botime në revistën shkencore “Optime” Sidrit Beqiraj prezanton temën “Efektete e zgjeruesit të shpejtë maksilar në pacientët në rritje” (evidencë X.5) dhe revista të tjera;

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabelat 16, 17 dhe 18 në aneks)

Specializantet e SPA “Ortognatodonci” jane te angazhuar ne kerkimin shkencor me botime, pjesmarrje ne aktivite shkencore dhe projekte.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 4 - Objektiva të programit të studimit të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë janë angazhimi i vazhdueshëm në punën klinike e kërkimore dhe nxitja e punës në ekip e studentëve.	
<p>Kriteri 1 Studenti angazhohet në punën klinike e kërkimore për aftësimin dhe përfundimin me sukses të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2 Studenti merr pjesë në aktivitete të ndryshme klinike të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjek studimet e specializimeve, të cilat e ndihmojnë të aftësohet për:</p> <ol style="list-style-type: none"> Përvetësimin e metodologjive dhe njohurive klinike e kërkimore për veprimtari krijuese të pavarura si: artikuj shkencorë, prezantime, etj.; Punën e pavarur në laborator/klinikë; Përdorimin e burimeve të informacionit (p.sh. bibliotekat dhe internetin, databazat me karakter shkencor/klinik) dhe administrimin e informacionit; Përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime publike; Përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave; Njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën klinike të specializantit. <p>Kriteri 3 Studenti i programit specializues merr pjesë në aktivitetet e parashikuara të programit të studimit jashtë punës së tyre klinike.</p> <p>Specializanti është i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo si referues në:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ligjërata; Seminare; Debate ndërdisiplinore, të organizuara në kuadër të programit të studimit të specializimeve; Mundësi të tjera të të mësuarit si: ndjekja e prezantimeve të konferencave dhe seminareve të ndryshme me karakter klinik. <p>Udhëheqësit i këshillojnë studentët të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore që i ndihmojnë në punën e tyre dhe klinike.</p> <p>Kriteri 4 Studenti fiton aftësi ⁴ për komunikimin e duhur me nivel profesional</p> <p>Kriteri 5 Studenti ndjek rregullat e sjelljes etike dhe profesionale me pacientët dhe kolegët dhe fiton aftësi për komunikim korrekt me të tjerët.</p>	<p>Stafi akademik i këtij programi studimi nxit dhe ndihmon specializantet të angazhohen në kverkim shkencor dhe ti paraqesin punimet e tyre në aktivitete shkencore.</p> <p>Lënda “Metodat e Kërkimit Shkencor” i pajis studentët me njohuri të metodologjisë së kërkimit shkencor tv domosdoshme për realizimin e temës së diplomës dhe punimeve shkencore të tyre..</p> <p>Stafi akademik i nxit studentët të marrin pjesë aktive në aktivitete shkencore.</p> <p>Duke u angazhuar në procesin kërkimor specializantët fitojnë aftësi për komunikimin e duhur me nivel profesional.</p> <p>Rëndësi në këtë program studimi i kushtohet respektimit të etikës dhe deontologjisë mjekësore.</p> <p>Specializantët kryejnë aktivitetin e tyre teoriko-praktik bazuar në rregulloren e programit të studimit, rregulloren e Klinikës Universitare dhe të gjitha rregulloreve të tjera të Njësise Kryesore dhe Institucionit.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	

⁴ Aftësitë e komunikimit të studentit përfshijnë: kompetencën për të përshkruar në mënyrë të qartë rastet klinike; përdorimin e argumenteve bindëse dhe artikullimin e qartë të ideve para pacientit dhe kolegeve; zotësinë për të debatuar dhe mbështetur të tjerët, të përfshirë, në klinikë, mbikqyrje ose demonstrime.

GVJ konkludon se :

- stafi akademik i nxit dhe ndihmon specializantët të marrin pjesë në procesin kërkimor-shkencor dhe ti paraqesin punimet e tyre në aktivitete shkencore dhe në botime në revista shkencore.
- rëndësi në këtë program studimi i kushtohet respektimit të etikës dhe deontologjisë mjekësore në angazhimin në procesin kërkimor, specializantët fitojnë aftësi për komunikimin e duhur me nivel profesional.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar në funksion të programit të SPA

Pjesa përshkrimore:

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

FSHM ka realizuar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi për këtë program studimi me disa universitete si: Universitetin Federico II të Napolit - Itali, Universitetin e Aquilas - Itali, Universiteti Aristotel i Selanikut, dhe me Institucione si” me Urdhërin e Stomatologëve të Shqipërisë, Shoqatën e Ortodontëve Shqiptarë, Institutin e Shëndetit Publik, etj.

Marrëveshja me Universitetin e L’Aquilas është nënshkruar nga të dy palët (Universiteti Albanian University dhe Universiteti i L’ Aquilas më 27 mars 2015 dhe rinovuar në 2017. Bashkëpunimi fokusohet në:

- Shkëmbimin e stafëve akademike, personelit kërkues shkencor dhe studentëve;
- Shkëmbim të publikimeve, materialeve shkencore, projekteve kërkuese;
- Zhvillimin e projekteve kërkimore;
- Organizimin e publikimeve të përbashkëta, konferencave dhe workshopeve.

Në kuadër të marrëveshjes, që Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka realizuar me Universitetin e L’Aquilas për programin e studimeve të specializimit është mundësuar ardhja e pedagogëve të këtij universiteti për të ofruar orë në auditor si dhe vizita të specializantëve në këtë institucion. Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka ndihmuar në realizimin e një Open Day (evidencë XI.1, XI.2) dhe 3 Kongreseve Ndërkombëtare, 2 nga të cilat të realizuara në Tiranë me pjesëmarrjen e specializantëve (evidencë XI.3) por edhe stafit të FSHM e Departamentit të Stomatologjisë dhe një në L’Aquila (Avenzano) (evidencë III.5) duke sjellë mundësi dhe kualifikime të mtejshme të stafit akademik të AU dhe mobilitet të stafit në këtë universitet. Gjithashtu falë bashkëpunimit me qendra shëndetsore jasht vendit është bërë e mundur shkëmbimi në kuadër të Erasmus for Young Entrepreneurs nga specializantja Ilda Gibrizi në Romë. (evidencë R.1).

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar. Bashkëpunimi me institucionet shkencore (Tabela 20 ne aneks)

Albanian University ka një sërë marrëveshesh me institucione të tjera shkencore : Instituti i Shëndetit Publik, Universiteti i Aquilas, Itali, Shoqata e Stomatologëve të Shqipërisë, Shoqata e ortodontëve Shqiptarë, Universiteti i Pizës, Itali, Universiteti i Napolit, Itali, Universiteti Aristotel i Selanikut, GrigoreT.Popa University of Medicine and Pharmacy Iasi për kërkim shkencor, shkëmbimin e stafëve akademike, personelit kërkues shkencor dhe studentëve;shkëmbim të publikimeve, materialeve shkencore, projekteve kërkuese.

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ konkludon se: FSHM pjesë e të cilit është Departamenti Stomatolgjisë i cili realizon programin e studimit të specializimit afatgjatë në “Ortognatodonci” ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucionet vendase dhe të huaja duke mundësuar përfitime edhe për këtë program studimi.

ANALIZA SWOT

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses-pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

a) Pika të forta

1. Programi i studimit “Studime Specializuese Afatgjata në “Ortognatodonci”” pranë Albanian University ofrohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
2. Ky program ka një mision dhe objektiva të qarta duke synuar përgatitjen e specialistëve të fushës me standarte të larta.
3. Pranë Albanian University ofrohet ky program për një specializim të munguar prej dekadash në Shqipëri, ndërkohë që tregu ka nevojë për specialistë në këtë specialitet dhe nevojat për trajtim ortodontik janë në rritje.
4. Programi i studimit “Studime Specializuese Afatgjata në “Ortognatodonci”” është një program bashkëkohor studimi i një cilësie të lartë, i hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës, në të cilin paraqitet një koordinim i mirë i teorisë me praktikën;
5. Institucioni është angazhuar për të rekrutuar staf akademik efektiv dhe me kontratë në programin e studimit SPA në “Ortognatodonci” me eksperiencë të gjatë akademike dhe profesionale si dhe me kualifikime në vende të ndryshme të botës si Itali, SHBA, Rumani etj. Personeli akademik i huaj pjesë e këtij programi është një ure lidhese e rëndësishme e eksperiencës më të mirë evropiane, aset që mundëson ecurinë pozitive të këtij programi.
6. Infrastruktura ku zhvillohet programi, ofron te gjitha mundesite per te zhvilluar pjesen teorike te programit, punen klinike me pacientet, pjesen laboratorike dhe kerkimin shkencor.
7. Funksinimi i NJBSC duke përpiluar raporte në lidhje më vlerësimin e brendshëm të institucionit, ka rritur kërkesat dhe cilësinë ndaj mësimdhënies dhe mësimnxënies.
8. Studentët e programit të studimit SPA në “Ortognatodonci” përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe nga marrëveshjet që Albanian University ka me universitete evropiane.

b) Pika të dobëta:

1. AU ka numër të ulët të projekteve kërkimore shkencore të mirëfillta kombëtare dhe ndërkombëtare në nivel të njësisë bazë të fituara.

c) Mundësitë:

1. Numër më të lartë aplikimesh në projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

d) Pengesat:

1. Mungesa e specialistëve të çertifikuar në këtë fushë në Shqipëri dhe që mund të përfshihen edhe në jetën akademike.
2. Një politikë jo promovuese ndaj specialistëve të fushave përkatëse në Dentistri.
3. Mungesa e kontrollit të shtetit ndaj dentistëve të pa specializuar dhe që merren me trajtimin e rasteve klinike që kanë nevojë për trajtim ortodontik të specializuar.

Rekomandime:

1. Të punohet akoma më shumë në lidhje më projektet kërkimore shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
2. Të shikohet mundësia që në buxhetin e këtij programi të parashikohet edhe trajtimi i disa rasteve klinike specifike të cilat kanë kosto të lartë trajtimi dhe që mund të mbështeten nga vetë institucioni. Në këtë mënyrë studentëve në programin e specializimit mund t'i krijohet mundësia të diagnostikojnë, ndjekin dhe trajtojnë një diapazon akoma më të gjerë pacientësh.

SWOT ANALYSIS

Analysis according to the SWOT method (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats)

a) Strengths

1. The program of long- term specialization in Orthodontics is organized according to applicable legal acts.
2. The mission and objectives of this program are clear, aiming to provide highly qualified specialists in Orthodontics.
3. Albanian University is offering this specialization program - which has not been offered in past decades in Albania - at a time when in Albania there is a lack of specialists in this field while the need of orthodontic treatment is increasing.
4. This is a high-quality, contemporary program organized in accordance with the market needs, that coordinatinates theory and practice.
5. The institution is committed to recruiting academic staff with long academic and professional experience, qualified abroad Albania such as in Italy, USA, Romania, etc. The foreign staff that is a part of the program is considered to be an asset enabling the positive performance of this program.
6. The institution provides the required infrastructure to develop the theoretical and clinical part of the program as well as labs and areas for scientific research.
7. Reports from NJSBC related to the internal evaluation of the institution, have increased the demand toward the quality of teaching and learning.
8. The agreements between the Albanian University and different European Universities offer benefits and opportunities for the students in this study program as well.

b) Weaknesses

1. AU has earned a low number of national and international scientific research projects.

c) Opportunities

1. Applying for more national and international scientific research projects.

d) Threads

1. Lack of certified specialists of Orthodontics in Albania who can be involved in academics.

2. A non-promotional policy for specialists in the respective fields in Dentistry.
3. The lack of proper government control over dentists dealing with clinical cases that need a specialized orthodontic treatment.

Recommendations:

1. *More can be done in regards to national and international scientific research.*
2. *The institution may provide in the program's budget the possibility to cover the treatment costs of some specific rare cases in order to offer a wider range of patients to be diagnosed and treated from students of the specialization program.*

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. Asoc Çeljana Toti

Prof. Asoc Etleva Droboniku

